



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Infermieri  
Kirurgjikale  
ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë: Universiteti “Aleksandër Moisiu ” Durrës**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.As. Nevila Heta
2. Prof.Dr.Vjollca Durro

Dhjetor 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu ” Durrës**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu ” Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr.273 datë 28.08.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR nr.333, dt.28/10/2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	I dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ETC
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Nuk është diplomë e përbashkët
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Nuk është diplomë e dyfishtë
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Sipas dokumentit (Tabelat ASCAL/ Tabela 7.pdf), PAE/PAK i angazhuar për realizimin e programit të studimit (viti akademik 2022 -2023): 9 PAE/2 PAK
18	Numri i studentëve:	- Për vitin akademik 2022-2023 janë 125 studentë - Për vitin akademik 2021-2022 janë 77 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit **Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”** zhvillohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore të Fakultetit të Studimeve Profesionale në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Ky program studimi vjen si riorganizim i programit të studimit **Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”** me 90 ECTS dhe 1.5 vite studimi. Riorganizohet me UMASR nr.273 datë 28.08.2020 nga 90 ECTS në 60 ECTS. Veprimtaria akademike e këtij programi studimi fillon në vitin akademik 2020-2021. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) është një institucion publik i arsimit të lartë i hapur me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005, me tre fakultetet si Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, Shkolla e Lartë Profesionale. Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës është riorganizuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, dhe u hapën dy fakultete të reja, Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike dhe Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, u riorganizuan njësitë kryesore të universitetit duke bërë të mundur që sot në përbërje të tij të jenë 6 fakultete si Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën. UNMD është akredituar në vitin 2017 dhe riakredituar me VBA nr. 18, datë 24.03.2022.

Fakulteti i Shkencave Politike Juridike; Fakulteti i Edukimit; Fakulteti i Studimeve Profesionale; Fakulteti i Biznesit; Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, politike, edukimit, IT dhe mjekësore. Fakulteti i Studimeve Profesionale përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës, Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë. Programi i studimit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore (DSHMT) të Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP). Në këtë departament zhvillohen pesë programe studimi si dhe tre programe studimi në bachelor, një master profesional dhe një program profesional jouniversitar.

Programi i studimit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale është hapur për herë të parë me Urdhër Nr. 242, datë 14.06.2012 të MASH, dhe riorganizuar me Urdhërin nr.273, date 28.08.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.

Programi i studimit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloren e institucionin, ligjin 80/2015 për “Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL. Ai është i organizuar në një vit akademike me 60 kredite, 2 (dy) semestra me kohë të plotë. Në fund të programit të studimit studenti pajiset me diplomë të ciklit të dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM; Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)**

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjyqimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Asc. Nevila Heta, Prof. Vjollca Durro . Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Aleksandra Xhamo.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.

Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UAMD INIEL e zhvilluar në datat 06 dhe 07. 06. 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UAMD.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 07.11.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 15/175 Prot., datë 08.11.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 21.07.2023, dhe me shkresë zyrtare Nr. 2042 Prot., datë 13.11.2023, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

Sipas shkresës me Nr. 2042 Prot., datë 13.11.2023 (bashkëlidhur në procedurë), Institucioni njofton se nuk ka komente mbi draft-raportin. Si rrjedhim, raporti finalizohet dhe kalon në statusin "raport final".

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti i Durrësit “Aleksander Moisiu” (UAMD) është institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005, dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 10 datë 07.04.2017. Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UAMD synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UAMD. Këto programe jo vetëm që tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre, UAMD ofron programe në shumë drejtime si shkenca ekonomike, juridike, politike, shkenca të aplikuara dhe inxhinierike këto programe ofrohen në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit në përgjithësi.</p> <p>Përmes këtij programi synohet përgatitja e profesionistëve të shërbimit shëndetësor dhe promovimit të rritjes së cilësisë së këtij shërbimi në përputhje dhe referuar Strategjisë Kombëtare për Shëndetësinë.</p> <p><i>(Evidenca nr.2 Strategjia Kombëtare për Shëndetësinë; Evidenca nr. 4 Statusi i UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionaleve. Referuar dokumentacionit mbështetës dhe RVB, GVJ konstaton se ky program është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UAMD dhe fushës së veprimtarisë së Departamentit sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL.</p> <p>Ky program synon përgatitjen e specialistëve në fushën e shërbimit kirurgjikal duke rritur kapacitetet e njerëzore të shërbimit shëndetësor me profesionistë të aftë. GVJ vlerëson se programi përputhet plotësisht me qëllimin dhe misionin e institucionit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 6 Plani i zhvillimit strategjik UAMD 2020-2025; Evidenca nr. 4 Statusi i UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UAMD një nga misionet e të cilit është përgatitja e profesionistëve të shëndetit të aftë për tu përshtatur dhe trajtuar situata të ndryshme shëndetësore dhe gjithashtu përgatitja e tyre për studime të mëtejshme.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është hartuar bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, Strategjinë e zhvillimit institucional të UAMD, Strategjinë kombëtare të punësimit dhe arsim, Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale</p> <p><i>(Evidenca nr. 19 Strategji Ndërkombëtarizimi; Evidenca nr 6. Plani zhvillimit strategjik UAMD 2020-2025; Evidenca nr. 4 Statusi i UAMD).</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës (UAMD) është institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005, dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 10 datë 07.04.2017.</p> <p>Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit.</p> <p>Programi Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale.</p> <p>Ky program synon përgatitjen e specialistëve në fushën e shërbimit kirurgjikal duke rritur kapacitetet e njerëzore të shërbimit shëndetsor me profesionistë të aftë. GVJ vlerëson se programi përputhet plotësisht me qëllimin dhe misionin e institucionit</p> <p>Programi Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është hartuar bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">x</p>

<p><b>Standardi I.2</b> Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas</p>	<p>Institucioni UAMD ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (hapur me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005 dhe akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit) Në përbërje të tij janë <b>pesë fakultete</b> me fusha të gjera veprimtarie , kjo tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademike dhe mbështetës.</p> <p><b>Programi i Studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike</b></p>




<p>direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p><b>Mjekësore</b>, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e Sistemit European të transferimit të krediteve ETC në përputhje të plotë me statusin e Universitetit dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Ky Departament është pjesë e <b>Fakultetit të Studimeve Profesionale</b>, i cili përbëhet nga këto njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detare;</li> <li>2. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës;</li> </ol>
	<p>Fusha së cilës i përket Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Studimeve Profesionale, sipas klasifikimit/kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe europian. Ky program i përket nivelit 7 të kualifikimit dhe siguron kualifikime për studentët e infermierisë dhe Mami.</p> <p><b>Departamenti i Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore</b> përgjegjës për ofrimin e këtij programi studimi ofron dhe këto programe studimi;</p> <p><b>a. Programet profesionale (2-vjeçare – 120 ECTS):</b> Ndihmës Dentist</p> <p><b>b. Programe në ciklin e parë të studimit</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Infermieri e Përgjithshme</li> <li>2. Fizioterapi</li> <li>3. Mami</li> </ol> <p><b>c. Programe të Ciklit të Dytë të Studimit:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</li> </ol> <p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet dhe logjistikën e nevojshme që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit. GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore .</p> <p>Referuar të dhënave mbi stafin akademik për vitin akademik 2021-2022 departamenti përbëhet nga <b>15 pedagogë PAE</b>, nga të cilët <b>1(një) me titullin Profesor</b>, <b>8 me gradën Doktor</b> i Shkencave, <b>3 anëtarë me specializime afatgjata në mjekësi dhe 3 anëtarë Msc.</b></p> <p><b>Gjithashtu, pjesë e departamentit janë dhe 53 anëtarë me kohë të pjesëshme, të cilët janë kryesisht mjekë të fushave kirurgjikale dhe që ushtrijnë veprimtarinë e tyre pranë Spitalit Rajonal të Durrësit.</b></p> <p>Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UMAD kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe jo publike.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim</p>	<p><b>NUK I PËRKET KËTIJ PROGRAMI</b></p>



specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.									
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<b>NUK I PËRKET KËTIJ PROGRAMI</b>								
<b>Konkluzione</b>	<p><b>Programi i Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofrohet nga Departamenti i Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të transferimit të krediteve ETC në përputhje të plotë me statusin e Universitetit dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.</b></p> <p>Fusha së cilës i përket Programi i Studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Studimeve Profesionale, sipas klasifikimit/kodifikimit të programit referuar direktivave kombëtare dhe europian. Ky program i përket nivelit 7 të kualifikimit dhe siguron kualifikime për studentët e infermierisë dhe Mami.</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>x</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				x
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			x						

<b>Standardi I.3</b>	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>UMAD është një institucion publik që ka një numër të konsiderueshëm studentësh në këtë program studimi. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Gjatë vizitës në Institucion GJV evidentoi marrëdhënie të ngushta mes strukturave akademike dhe administrative, ndërmjet Fakulteteve si dhe Departamenteve të të njëjtit Fakultet, ku detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave dhe personelit specifikohen në Statusin dhe rregulloret përkatëse. Kjo gjë mundëson dhe lehtëson mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Kështu Departamenti bashkëpunon me Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, Drejtorinë e Planifikimit, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë etj. Bashkëpunimi dhe detyrat brenda njësisë bazë apo programeve bazohen në rregulloren e funksionimit të FSP dhe Departamenti Shkencave Mjekësore ku realizohet programi i studimit.</p> <p><i>(Evidenca nr.20 Rregullore për Qarkullimin dhe Arshivimin e Dokumentacionit UAMD; Evidenca nr.33 Struktura e UAMD; Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP; Evidenca nr. 4 Statuti UAMD)</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e programeve të ciklit të dytë Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" institucioni i UMAD ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të tjera të Arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit të cilat ofrojnë programe te ngjashme studimi dhe me institucione shëndetësore, brenda profilit të programeve të studimit që ofron. Një numër i konsiderueshëm lektorësh të jashtëm dhe zhvillimi i praktikave profesionale ofrohet nga këto institucione.</p> <p>Institucioni vuri në dispozicion të GVJ marrëveshje bashkëpunimi me instucione homologe akademike dhe shëndetësore si shtetërore dhe private si Spitalin Rajonal Durrës, Auxila Akademie, FSHT UNI "Ismail Qemali" Vlorë, Qendrën e Emergjencave Civile, Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë, Klinika Salveo Clinic, Klinika Fizio Vizion, Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë, Kompania Edar Medical, Qendrat Shëndetësore nr 1 dhe nr 6, Universiteti i Mjekësisë Tirana, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore. Me anë të këtyre marrëveshjeve është synuar dhe realizuar zhvillimi i praktikave profesionale, realizimi i temave të diplomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimi i kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë.</p> <p>UMAD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunim me IAL dhe projekte bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studentë në kuadër të programit ERASMUS, si dhe një sërë projekte ndërkombëtare në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p><i>(Evidenca nr.34 Marrëveshjeve bashkëpunimit UAMD; Evidenca nr.38 Projektet e UAMD ; Evidenca nr. 36 Mobilitetet e UAMD ( staf dhe studentë)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për realizimin e këtij program studimi, FSHMT dhe departamenti ku realizohet ky program studimi, në fillim të vitit akademik caktojnë koordinatorët e praktikës dhe institucionit ku realizohet praktika profesionale apo aktivitetet të tjera për mbikqyrjen dhe koordinimin e realizimit të praktikës profesionale apo temave të diplomës.</p> <p>Praktika mbikqyret nga koordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Vlerësimi i praktikës kryhet sipas rregullores përkatëse të UAMD. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstatoi se programi ka formularin e aplikimi për praktikën profesionale, formularin e vlerësimit të praktikës profesionale nga pedagogu mbikqyrës dhe institucioni ku studenti ka kryer praktikën. Formulari i aplikimi për praktikën profesionale, plotësohet nga studenti dhe i dorëzohet koordinatores së departamentit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 34 Marrëveshjeve bashkëpunimit; Evidenca 6.5. Rregullore e praktikës profesionale.)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ evidentoi që në mënyrë periodike Koordinatorin i Programit të Studimit harton Raporte mbi mbarëvajtjen e</p>

<p>studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshjeve të Bashkëpunimit dhe ecurinë e studentëve në këto institucione (Raporte mbi Ecurinë e Bashkëpunimit).</p> <p>Departamenti si njësi bazë ku realizohet ky program studimi, në bashkëpunim me zyrën e marrëdhënieve me jashtë në mënyrë periodike analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" si mobilitetin e studentëve dhe stafin akademik, ecuria e zhvillimit të praktikës profesionale, realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me institucionet arsimore dhe shëndetësore, realizimin e projekteve të ndryshme. Të dhënat analizohen në analizën vjetore të departamentit</p> <p><i>(Takimi me stafin akademik; Evidenca nr. 126 Raporti Analitik me institucionet e bashkëpunimit)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Institucioni ka siguruar marrëdhënie të ngushta mes strukturave akademike dhe administrative, ndërmjet Fakulteteve si dhe Departamenteve të të njëjtit Fakultet, ku detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave dhe personelit specifikohen në Statusin dhe rregulloret përkatëse. Kjo gjë mundëson dhe lehtëson mbarëvajtjen e programit të studimi.</p> <p>Për realizimin e programit institucioni i UMAD ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të tjera të Arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi dhe me institucione shëndetësore, brenda profilit të programeve të studimit që ofron. Një numër i konsiderueshëm lektorësh të jashtëm dhe zhvillimi i praktikave profesionale ofrohet nga këto institucione.</p> <p>Institucioni vuri në dispozicion të GVJ marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe akademike dhe shëndetësore si shtetërore dhe privat.</p> <p>Koordinatori i Programit të Studimit harton Raporte mbi mbarëvajtjen e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit dhe ecurinë e studentëve në këto institucione.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është hapur për herë të parë me Urdhër Nr. 242, datë 14.06.2012 të MASH, dhe riorganizuar me Urdhërin nr.273, datë 28.08.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloren e institucionin, ligjin 80/2015 për "Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL. Ai është i organizuar në <b>1(një) vit akademik me 60 kredite, 2 (dy) semestra me, kohë të plotë</b>, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015.</p> <p><i>Ngarkesa totale në ore mësimore është 705 nga të cilat 150 orë i takojnë praktikës profesionale baraz me 6 kredite dhe 200 orë punë individuale dedikur mikrotezës konvertuar në 8 kredite.</i></p> <p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Në fund të programit të studimit studenti pajiset me diplomë të ciklit të dytë Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale</p> <p>Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë 6 ECTS (10%) 5%-10%</li> <li>- Lëndë karakterizuese 22 ECTS (36.6%) 30% - 40%</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 18 ECTS (30 %) 20%-30%</li> <li>- Lëndë plotësuese 6 ECTS (10%) 10%</li> <li>- Detyrime përmbyllëse dhe diploma 8 ECTS (13.5%) 10%-20%</li> </ul> <p>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS/ përqindje është bërë konform përcaktimeve të VKM nr 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p> <p><b>(Evidenca 121. Dosja e programit të studimit).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të</p>	<p>Programi i studimit MP në "Infermieri Kirurgjikale" është organizuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Ky program përmban një informacion të plotë në fushën e infermierisë kirurgjikale duke i pajisur studentët me njohuri dhe kompetenca në vlerësimin dhe ndjekjen e pacientëve të cilët i nënshtrohen <i>procedurave kirurgjikale, gjithashtu programi mundëson dhënien e njohurive në patologjitë</i></p>

<p>përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><i>onkologjike, defektet e lindura neonatale që i nënshtrohen trajtimit kirurgjikal, kirurgjise obsetrikale dhe gjinekologjike, ortopedisë dhe traumatologjisë, kujdesit post operator, kirurgjise robotike etj.</i></p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale që i shërbejnë si bazë për kualifikime të mëtejshme. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni.</p> <p>Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike për profilet të veçanta të infermierit kirurgjikal, që lidhen me nevojat e tregu të punës. Njohuritë e fituar i shërbejnë studentit, për të vlerësuar, përballuar dhe zgjidhur problematika të vështira në sallat kirurgjikale apo shërbime të tjera shëndetësore gjithashtu ky program rrit aftësitë e studentëve për dhenien e diagnozave të ndryshme infermierore.</p> <p>Gjithashtu njohuritë e fituar në këtë program studimi shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në Master Shekncor apo trajnimeve të tjera.</p> <p><b><i>(Evidenca nr.10 Rregullorja e programit të studimit; Evidenca nr.132 Kurrikula “Infermieri e Përgjithëshme”; Evidenca nr. 121. Dosja e programit të studimit)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është i organizuar me kohë të plotë në një vit akademik të ndarë në dy semestra në total 60 ECTS. Praktika profesionale realizohet në institucionet shëndetësorë me të cilat institucioni ka marrë veshje bashkëpunimi dhe mbikëqyrjet nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika. Vlerësimi bëhet nga pedagogu mbikëqyrës dhe insitucioni ku realizohet praktika. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën. Në fund të praktikës studentët vlerësohen me provim përkatës. Në programin mësimor përfshihet praktika profesionale prej 150 orësh përkthyer në 6 kredite, punim i diplomës 200 orë përkthyer në 8 kredite.</p> <p><b><i>(Evidenca 121. Dosja e programit të Studimit)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>NUK I TAKON KËTIJ PROGRAMI</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-</p>	<p>NUK I TAKON KËTIJ PROGRAMI</p>

pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NUK APLIKOHET
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" realizohet në Departamentin e Shkencave Mjekësore të Fakultetit të Studimeve Profesionale në përputhje me misionin dhe objektivat e këtij institucioni. Ky është i vetmi program master në këtë fushë që ofrohet nga institucioni.
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", i ofruar nga FSP ka kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimi të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Lëndët dhe modulet që realizohen në këtë program studimi janë të pajisur me një kod unik i cili përputhet me kodin që ka në syllabus dhe programin mësimor. <i>(Evidenca nr. 26 Tabela e kodifikimit të programeve në UAMD)</i>
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	NUK APLIKOHET
<b>Konkluzione</b>	<p>Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloren e institucionin, ligjin 80/2015 për "Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL. Ai është i organizuar në <b>1(një) vit akademik me 60 kredite, 2 (dy) semestra me, kohë të plotë</b>, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015.</p> <p>Ky program studimi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Në fund të programit të studimit studenti pajiset me diplomë të ciklit të dytë Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale.</p> <p>GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS/ përqindje është bërë konform përcaktimeve të VKM nr 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>Në programin mësimor përfshihet praktika profesionale prej 150 orësh përkthyer në 6 kredite, punim i diplomës 200 orë përkthyer në 8 kredite.</p>




	Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, i ofruar nga FSP ka kodin përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimi të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore pranë Fakultetit të Shkencave Profesionale. FSHP është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë”. Autoritet drejtuese janë dekani dhe drejtuesit e departamenteve, koordinatori i programit.</p> <p>Në përberje të tij janë 3 njësi bazë: Departamenti i “Shkencave Teknike Mjekësore”, Departamenti “Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës” dhe Departamenti “Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë”, njësitë ndihmëse si laboratorë mjekësorë, dhe administrata që është në nivel universiteti (sekretaria mësimore, biblioteka burimet njerëzore, financa, IT) personeli ndihmës mësimor shkencorë për laboratorët mësimorë dhe klinikë.</p> <p>Departamenti “Shkencave Teknike Mjekësore” është i ndarë në tre Grupe Mësimore- Kërkimore Shkencore:</p> <p>Grupi Mësimor- Kërkimore Shkencor paraklinik Grupi Mësimor- Kërkimore Shkencor klinik Grupi Mësimor- Kërkimore Shkencor Teknik Mjekësor <i>(Evidenca nr. 56 Organigrama e FSP, Evidenca nr. 134 Memo për ndarjen e grupeve Mësimore Kërkimore Shkencore)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Njësia bazë ku realizohet ky program studimi ka angazhuar staf akademik dhe ndihmës akademik mësimor për realizimin e praktikave mësimore laboratorike, praktikave profesionale. Staf ndihmës akademik asiston pedagogët për realizimin e programit mësimor. Për realizimin e programit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc.</p> <p>Pjesë e stafit të programin është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor/laboranti me formimn e duhur profesional, cili është përgjegjës për organizimin e praktikave laboratorike mësimore dhe asiston pedagogët në realizimn e procesit mësimorë si dhe studentët në kryerjen e procedurave të ndryshme laboratorike. FSHP disponon 8 laboratore nga të cilët 4 i takojnë departamentit të Shkencave Mjekësore. Praktika profesionale të programit ndiqen nga staf akademik dhe personel spitalor të cilët janë në kontakt në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me raportimin për mbarëvajtjen e praktikave. Praktikant janë organizuar në</p>

	<p>grupe me 5 veta të cilët mbikqyren nga titullari i lëndës dhe nga kryeinfermierja.</p> <p><i>(Evidenca nr. 136 Grafiku praktikave spitalore të studentëve; Evidenca nr. 101 Raport mbi laboratorët e DSHMT)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e FSHP programi i studimit ka të emëruar koordinatorin e programit të emëruar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani. Koordinatorin e programit përzgjidhet nga personeli akademik i programit, mbështet hartimin e kurikulave, përgatit raportin vjetor për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit, kontrollon syllabuset dhe asiston në përditësimin e tyre, kujdeset për ecurinë e praktikave profesionale, mban kontakte dhe ndihmon në organizimin e takimeve me biznesin, ndjek aktivitetin shkencor të programit dhe problematikat e ndryshme dhe raporton te shefi i departamentit për realizimin e programit mësimor.</p> <p><i>(Evidenca nr.9 Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore; Evidenca nr. 113 Memo e departamentit për koordinatorin e masterit; Evidenca nr. 126 Raporti i koordinorit për ecurinë e programit të studimit Rregullore e Fakultetit FSHP)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Programi Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore pranë Fakultetit të Shkencave Profesionale. FSHP është organizuar bazuar në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë". Autoritet drejtuese janë dekani dhe drejtuesit e departamenteve, koordinatori i programit.</p> <p>Në përberje të tij janë 3 njësi bazë: Departamenti i "Shkencave Teknike Mjekësore", Departamenti "Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës" dhe Departamenti "Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë", njësitë ndihmëse si laboratorë mjekësorë, dhe administrata që është në nivel universiteti (sekretaria mësimore, biblioteka burimet njerëzore, financa, IT) personeli ndihmës mësimor shkencorë për laboratorët mësimorë dhe klinikë.</p> <p>Për realizimin e programit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc.</p> <p>Pjesë e stafit të programin është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor/laboranti me formimin e duhur profesional.</p> <p>Bazuar në rregulloren e FSHP programi i studimit ka të emëruar koordinatorin e programit të emëruar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>x</p>

**Standardi II.3**

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit e vënë në dispozicion konstaton se departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 121. Dosja e programit të Studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 1(një) vit akademik të ndara në 2 semestra. Numri i ETC është 60 ETC Numri i ETC është 60 ETC 1500 orë mësimore prej të cilave 705 janë orë në auditor dhe 795 orë jashtë auditorit.</p> <p>Praktike profesionale :6 Kredite Detyrime Përmbysë- Mikroteza 8 kredite.</p> <p>Plani mësimor përshin lëndet/ disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, laboratorëve, praktikave, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit. Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në masën mbi 75%, ndërsa frekuentimi i laboratorëve në masën 100%. Një orë mësimore është 50 minuta.</p> <p><i>(Evidenca 121. Dosja e programit të Studimit, Ev 8 Rregullore FSP)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se Institucion disponon dhe jep informacion të detajuar, për studentët, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Në takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kriteret specifike të përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM. Kriteret specifike të pranimit dhe kuotat përcaktohen nga njësia bazë dhe i përcillen njësisë kryesore dhe më tej Rektoratit. Për ndjekjen e studimeve në këtë cikël kandidatëve i nevojitet të paktën një diplomë e ciklit të parë në fushën e infermierisë ose mamisë të univesiteteve të vendit ose të huaja, gjithashtu institucioni ofron mundësinë e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve midis programeve si brenda institucionit ashtu nga institucione të tjera të arsimit të lartë.</p> <p><i>(Evidenca nr.110 Vendim për kriteret e pranimit Master Profesional Infermieri Kirurgjikale; Evidenca nr. 91 Memo për njohjen e krediteve)</i></p>

	<i>të mëparshme; Evidenca nr. 90 Urdhër mbi ngritjen komisionit të transferimit të studimeve)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programi i studimit përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon në programin Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/profesionle, ETC përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit. Programi ka rregullore për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Syllabuset janë organizuar/ formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</li> <li>- Titullari i lëndës janë të kategorisë profesor sipas Ligjit80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 58 "Statusi i personelit akademik".</li> <li>- Lektorët janë të gjithë të kategorisë Profesor dhe Doktorë i shkencash.</li> <li>- Formimi profesional i pedagogut përputhet me lëndën që zhvillon.</li> </ul> <p><i>(Evidenca nr. 123-124 Syllabuset e MP "Infermieri Kirurgjikale")</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>Në takimin me stafin akademik dhe në dokumentacion u evidentua se ky është një program i riorganizuar 2 vitet e fundit dhe akreditohet për herë të parë si i tillë ende nuk i është nënshtruar ndryshimeve apo përditësimeve. Njësia bazë është e motivuar që në të ardhmen program të përmirësohet në varësi nevojave të tregut të punës dhe sigurisht të rejave shkencore të fushës.</p> <p><i>(Evidenca nr. 121 Dosja e programit të Studimit)</i>  <i>( Evidenca nr .117 Urdhër për riorganizimin e programit)</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p>Departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lëndë si dhe sekretaria mësimore.</p> <p>Institucion disponon dhe jep informacion të detajuar , për studentët, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Struktura programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/profesionle, ETC përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon</p>

	lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 1(një) vit akademik të ndara në 2 semestra. Numri i ETC është 60.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kreditë [kurrikula e programit]. Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në %) për veprimtaritë formuese përputhet me legjislacionin në fuqi VKM 41. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Përmbajtja e çdo lënde të këtij Programi Studimi mundëson marrjen e njohurive të plota në fushën e Infermierisë Kirurgjikale. Secila lëndë është strukturuar në mënyrë të atillë, që të ketë edhe praktikatat të përfshira, për një përvetësim më të mirë të teorisë së trajtuar. Të gjitha lëndët infermierore
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Organizimi i Programit të Studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale” bën grupimin e moduleve në lëndë, të shpërndarë në dy semestra akademik dhe 60 kredite, ku orët mësimore përcaktohen bazuar në kreditet e secilës lëndë. Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale.
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Përmbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përfituara në ciklin e parë të studimit dhe profilizimin e tyre në një fushën më të ngushtë në atë të Infermierisë Kirurgjikale duke bërë të mundur përfitimin e aftësive, shprehive për të përfituar aftësitë e duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja në kategori i veprimtarisë formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, bën të mundur arritjen e objektivave të programit.

	<p>Kështu gjatë semestrit të parë 30 kredite merren nga mesimi në auditor ndërsa gjatë semestrit të dytë 14 kredite merren nga orët në auditor 6 kredite nga praktika profesionale dhe 8 kredite nga mikroteza. Nga vlerësimi programit të studimit evidentojmë se ka një raport 2/1 leksione semoinare për të gjitha orët në auditor. Në kurrikulën e këtij programi parashikohen 150 orë mësimore profesionale e cila organizohet në grupe të vogla për të optimizuar angazhimin e studentëve në sallat kirurgjikale. Në institucion është ngritur dhe është funksional Laboratori i Kirurgjisë i cili bën të mundur aftësimin e studentëve të këtij programi duke bërë similitim të procedura në sallën kirurgjikale. Kështu procedura të tilla si : përgatitja preoperatore, sterilizimi asitimi i kirurgut praktikohen dhe mësohn pikërisht në këtë laborator. ( vizita e ambienteve)</p> <p>Me këtë shpërndarje dhe sigurisht me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre . Vlerësimi realizohet në anë të dy provimeve , provimi i ndërmjetëm i cili realizohet në javën 7 dhe 8 dhe provimi përfundimtar.</p> <p>Gjithashtu vlerësojmë se duke qene se studentët në këtë cikël marrin njohuri më të acancuara dhe më të thelluara në fushën e infermieristikës në sallën kirurgjikale kanë mundësi shumë të mira për avancuar studimet e tyre në nivelin e masterit shkencor, gjithashtu i krijon mundësi studenteve për transferuar studimet e tyre në programe të tjera studimi. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk evidentuam transferime drejt ketij programi studimi dhe as nga ky program drejt programeve të tjera.</p> <p>Vlerësojmë që kompetencat profesionale dhe aftësitë e studentëve pas përfundimit të ketij cikli studimi janë në një nivel të kënaqshëm.</p> <p>Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij ju krijon mundësi punësimin studentëve në sektorin publik dhe privatë. Në RVB theksohet se përpilimi i këtij i programi është bazuar në eksperiencat ndërkombëtare por GVJ nuk gjeti të dhëna të dokumentuara.</p> <p>Asnjë nga studentet e këtij programi nuk ka qenë pjesë e ndonjë programi shkëmbimi apo mobiliteti panvarësisht se institucioni ka një sërë marrëveshesh bashkpunimi dhe projektesh në proces. Drejtuesit deklarojnë se krijimi i mobilitetit për studentet e fushave mjekësore ka rezultuar i vështirë aq më tepër vlerësojmë që periudha e shkurtër e studimit vetëm prej 1 viti nuk e favorizon mobilitetin.</p> <p><i>(Evidenca nr. 121. Dosja e programit të Studimit;Evidenca nr. 123-124 Syllabuset e MP “Infermieri Kirurgjikale”;Evidenca nr.10 Rregullore e e programit të studimit; Evidenca nr. 129 Tabela e regjistrimeve, transferimeve, çregjistrime)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën</p>	<p>FSHMT dhe njësitë bazë kanë një praktikë lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo sylabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekse mësimorë të pedagogëve të UAMD, cikle leksionesh të shkruara të përgatitura nga pedagogët e</p>

bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	lëndës. Tekset mësimorë për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjendet në fund të çdo syllabusi.			
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e Infermierisë Kirurgjikale aftësimin profesional teorik dhe praktik në zgjidhjen e situatave klinike, kryerjen e procedurave të sakta në sallën kirurgjikale. <i>(Evidenca nr. 10 Rregullore e eprogramit të studimit; Evidenca nr. 129 Tabela e regjistrimeve, transferimeve, çregjistrime)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive në fusha specifike dhe të avancuara të Infermierisë Kirurgjikale si kirurgjia robotike, ambientet operatore me teknologji të avancuar, metodat e avancuara kirurgjikale etj. Këto njohuri krijojnë mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme apo ndjekje të doktoraturës. Lëndët/ modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitimin e kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. <i>(Evidenca nr.116 Tregu i punës)</i>			
<b>Konkluzione</b>	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Përmbajtja e çdo lënde të këtij Programi Studimi mundëson marrjen e njohurive të plota në fushën e Infermierisë Kirurgjikale. Përmbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përfutuara në ciklin e parë të studimit dhe profilizimin e tyre në një fushë më të ngushtë në atë të Infermierisë Kirurgjikale duke bërë të mundur përfitimin e aftësive, shprehive për të përfutuar aftësitë e duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre. Në kurrikulën e këtij programi parashikohen 150 orë mësimorë profesionale e cila organizohet në grupe të vogla për të optimizuar angazhimin e studentëve në sallat kirurgjikale. Me këtë shpërndarje dhe sigurisht me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Nuk eidentuam transferime drejt këtij programi studimi dhe as nga ky program drejt programeve të tjera.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

#### Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Institucioni i kushton një vëmendje të rëndësishme hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit në bashkëpunim të stafit akademik (takimi me stafin) dhe institucionet bashkëpunuese më qëllim përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Departamenti me qëllim përmirësimin e programit të studimit në fillim të vitit akademik bën përditësimin e programit të studimit. Në këtë proces një vënd të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues nga institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, spitalet, klinika private dhe shtetërore në të cilat realizohet praktika profesionale, alumni me medimet e tyre pas përballjes me tregun e punës. Në këtë proces institucioni përfshin edhe studentët të cilët mund të shprehin mendimin e tyre përmes pyetësorëve, gjithashtu njësia bazë fton në diskutime studentë të cilët kanë mbaruar këtë program studimi por edhe studentë në vazhdim të programit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshillin studentor, senatin akademik.</p> <p>Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe për studentët e diplomuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</p> <p>Pas mbledhjes së sugjerimeve njësia bazë merr vendimin për riorganizimin apo jo të programit duke i përcjellë propozimin në nivele të tjera të cilat ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e ndryshimeve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 176 Formulari i vlerësimit të lektorit; Evidenca nr. 11 Rregullore e NJSBC ; Evidenca nr. 8 Rregullore FSP)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Rishikimi i programit ashtu si dhe në degët e tjera kryhet duke ju referuar dhe kërkesave të tregut të punës për infermierw të profilizuar. Institucioni deklaron që përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale në bashkëpunim me shoqatën e infermierëve, QSUT, qendrën kombëtare të urgjencës mjekësore të cilat ofrojnë dhë propozime në lidhje me pasurimin dhe përmirësimin e programin duke u bazuar në eksperiencën e tyre direkte në shërimin ndaj pacientit.</p> <p>Gjithashtu gjatë studimit të tregut të punës departamenti ka vjelur edhe opinionet e institucioneve ku studentët e këtij program janë punësuar për të vlerësuar formimin e tyre dhe aftësitë e përshtatjes në sallat kirurgjikale.</p> <p><i>(Evidenca nr.94 Marrëveshjet e bashkëpunimit DSHTM; Evidenca nr.95 Korrespondenca me Spitalin rajonal Durrës)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Departamenti me qëllim përmirësimin e programit të studimit në fillim të vitit akademik bën përditësimin e programit të studimit. Në këtë proces</p>

	<p>një vënd të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues nga institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, spitalet, klinika private dhe shtetërore në të cilat realizohet praktika profesionale, alumni me medimet e tyre pas përballjes me tregun e punës.</p> <p>Rishikimi i programit ashtu si dhe në degët e tjera kryhet duke ju referuar dhe kërkesave të tregut të punës për infermierë të profilizuar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x


Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka si objektiv kryesor formimin profesional dhe shkencor bashkëkohor të studentëve, duke qënë nje master profesional, ky program studimi i pajis studentët me kompetencat e duhura për të përballuar sfidat praktike në këtë fushë por gjithashtu i orienton drejt kërkimit shkencor me anë të detyrave të kursit dhe gjithashtu përpunimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. Programi ofron lëndë specifike sic është Metodatat të Kërkimit Shkencor dhe Statistikë, në funksion të orientimit dhe ambientimit të studentit në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p><i>( Evidenca nr 4 Statuti i UAMD , Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>Njësia kryesore dhe bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike.</p> <p><i>(Evidenca nr 44 Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike dhe financiare)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Program i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” panvarësisht së është një master profesional i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesëmarrjen e tyre në seminare, konferencave shkencore studentore, jo vetëm të UAMD po edhe jashtë tij. Pedagogët dhe udhëheqësit shkencorë i mbështesin studentët për publikimin e punimeve të kryera.</p> <p><i>(Evidenca nr 73 Përmbledhje e konferencave studentore )</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe	<p>Njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Bazuar kjo në rregulloren e FSP, ku përcaktohet që njësia bazë në fillim të cdo viti akademik përcakton fushat, drejtimet, dhe afatet e veprimtarisë shkencore. Bazuar në këto nevoja</p>

administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>institucioni parashikon çdo vit një buxhet të veçantë dhe mbështet financiarisht për realizimin e punëve kërkimore shkencore.</p> <p>Program i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” panvarësisht se është një master profesional i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor.</p> <p><i>(Evidenca nr. 63 Plani financiar vjetor FSP; Evidenca nr. 8 Rregullore FSP)</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka si objektiv kryesor formimin profesional dhe shkencor bashkëkohor të studentëve, duke qënë nje master profesional, ky program studimi i pajis studentet me kompetencat e duhura për të përballuar sfidat praktike në këtë fushë por gjithashtu i orienton drejt kërkimit shkencor.</p> <p>Studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesëmarrjen e tyre në seminare, konferencave shkencore studentore, jo vetëm të UAMD po edhe jashtë tij. Pedagogët dhe udhëheqësit shkencorë i mbështesin studentët për publikimin e punimeve të kryera.</p> <p>Njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				x

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>UAMD i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. FSP për realizimin e punëve kërkimore shkencore ka marrëveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore rajonale.</p> <p>ILA disponon dy qendra të kërkimit shkencor dhe gjithashtu ka funksionale drejtorinë e projekteve e cila ka funksion të informojë dhe të trajtojë stafin akademik në lidhje me aplikimin dhe shkrimin e projekteve ndërkombëtare dhe pas miratimit monitoron zbatimin dhe realizimin e tyre. Momentalisht Departamenti Shkencave Mjekësore ka në zhvillim dy projekte ndërkombëtare. UAMD financon artikujt e publikuar në revistata të indeksuara.</p> <p><i>(Evidenca nr. 35 Rregullore e drejtorisë së projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë; Evidenca nr. 38 Projektet e UAMD; Evidenca nr. 45 Politikat e zhvillimit të stafit akademik)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë</p>	<p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësia kryesore në fusha dhe probleme të veçanta të mjekësisë. Në këto aktivitete UAMD ka qënë organizatore ose partnere. Një vend të</p>



<p>personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>rëndësishëm zënë dhe ditët e hapura, leksionet e hapura me pedagogë të ftuar, ku studentët janë pjesmarrës aktive në këto aktivite nëpërmjet paraqitjes së temave të studimit, rezultateve të projekteve ku kanë qënë pjesmarrës me pedagogët e tyre apo botime në revista shkencore të universitetit. <i>(Evidenca nr. 70 Analiza vjetore e kërkimit shkencor FSP; Evidenca nr. 71 Buletini aktiviteteve FSP)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi studimit, bazuar në objektivat dhe misionin e tij, synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e “Infermierisë Kirurgjikale” dhe përgatitjen e infermierëve me kompetenca dhe afësi të shtuara profesionale më qëllim përballimin e sfidave që ato mund të ndeshin në sallat operatore dhe gjithashtu për tu përshtatur dhe qenë komod me teknologjitë e reja operatore të cilat kanë tendencë gjithnjë e më rritje të aplikohen në proceset kirurgjikale. <i>( Evidenca nr. 116 Tregu i punës)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, zbaton rekomandimet e nxjerra nga Urdhëri i Infermierit, duke i ardhur në ndihmë studentëve në procesin e marrjes së licencës së profesionit. Njësia bazë reflekton rekomandimet e Urdhërit dhe Shoqatës së Infermierëve duke marrë vendime në lidhje me nevojat e ndryshimit të kurrikulës apo përmirësimeve të programit të praktikave profesionale. <i>(Evidenca nr. 94 Marrëveshje bashkëpunimi)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” përputhet me aktet ligjore, direktivat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>ILA disponon dy qendra të kërkimit shkencor dhe gjithashtu ka funksionale drejtorinë e projekteve e cila ka funksion të informojë dhe të trajtojë stafin akademik në lidhje me aplikimin dhe shkrimin e projekteve ndërkombëtare dhe pas miratimit monitoron zbatimin dhe realizimin e tyre. Mënyrë Departamenti Shkencave Mjekësore ka në zhvillim dy projekte ndërkombëtare. UAMD financon artikujt e publikuar në revistata të indeksuara</p> <p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësia kryesore në fusha dhe probleme të veçanta të mjekësisë</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, zbaton rekomandimet e nxjerra nga Urdhëri I Infermierit, duke i ardhur në ndihmë studentëve në procesin e marrjes së licencës së profesionit</p>




	Programi i studimit Mastër Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” përputhet me aktet ligjore, direktivat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara.			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për realizimin e procesit mësimor UAMD përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Power Point, biseda interaktive me studentët apo temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre. Stafu akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimi apo praktikës mësimore. Numri i ETC është 60 ETC 1500 orë mësimore prej të cilave 705 janë orë në auditor dhe 795 orë jashtë auditorit. Praktike profesionale :6 Kredite Detyrime Përmbyllëse- Mikroteza 8 kredite. <i>(Evidenca nr. 10 Rregullore e programit të studimit;Evidenca nr.121 Dosja e programit të studimit)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit të tyre profesional teorik. Format e mësimi teorik dhe praktik janë: leksionet, seminarat, orët e ushtrimeve, praktikatat profesionale, detyrat e kurtsit, projektet etj. Frekuentimi i oreve teorike është i detyrueshëm në masën 75%. Për zhvillimin e praktikave laboratorike mësimore institucioni ka krijuar infrastrukturë laboratorike, laboratorët infermierore janë të paisur me mulazhe dhe paisje bashkëkohore, të cilat ju shërbejnë studentëve për aftësimin e tyre praktik profesional. Gjatë takimit me stafin u evientua që të gjithë pedagogët ishin të hapur dhe aplikonin me kënaqësi metodat alternative duke i përgjigjur më së miri nevoja dhe aspiratave në rritje të studentëve.

	<i>(RBV, takimime stafin akademik, vizita në institucion; Evidenca nr. 101 Organizimi i Labororit të Kirurgjisë)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në program bashkëpunimi për shkëmbim eksperiencave midis IAL në kuadër të programeve Erasmus, konferenca shkencore, aktivitetet trainuese sipas shkallës së kualifikimit, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. Gjithashtu institucioni ka krijuar kushte optimale infranstrukturore, laboratorë të mirëpajisur ku vetëm në Fakultetin e Studimeve Profesionale ka 4 laboratorë të Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore . <i>(Evidenca nr. 101 Organizimi i Labororit të kirurgjisw; Evidenca nr. 45 Politika të zhvillimit të stafit akademik; Evidenca nr.10 Rregullore e programit të studimit)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentet mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperincë mjekësorë dhe pedagogjike në lëndët që zhvillon. GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit konstaton se formimi profesional përputhet me lëndën që zhvillon në këtë program studimi. Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin institucioni mundëson stafi akademik përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënie si projektorët, prezantime power point, metoda interaktive. Siç është theksuar edhe në standartet e mësipërme IAL ka investuar në krijimin infrastrukturën e nevojshme laboratorike për demonstrimin e praktikave mësimore. Në funksion të këtij programi studimi pranë Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore funksionojnë 4 laboratorë të mirëpajisur (laboratori i kirurgjisë, laboratori i infermierisë, laboratori i mamisë dhe fizioterapisë). Infrastruktura dhe gjithashtu pajisia e studentëve me tekste dhe materiale teorike dhe didaktike të përmirësuara ndikon drejtpërdrejtë në transmetimin e duhur të njohurive, nxit pavarësinë e mendimit, analizën dhe aftësitë dedektuese tek studentët. <i>(Evidenca nr. 75 Stafit akademik i departamentit, Evidenca nr; 76 Lektorët me fusha specifike)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit apo përfaqësimit të tyre në astruktura drejtuese si senati akademik. Metodat e vlerësimit të mësimdhënies përfshijnë : Vëzhgimi i orëve mësimorë nga përfaqësues të njësisë bazë për evidentimin e metodave të mësimdhënies. Orët mësimore të hapura të stafit akademik më më eksperiencë. Leksionet e hapura me përfaqësues specifik në fushën e kirurgjisë.

	<p>Një mënyrë e rëndësishme përmirësimi në lidhje me metodat e mësimdhënies lidhet edhe me reflektimet e rezultateve të pyetësorëve. (<i>Evidenca nr.139 Ceepus Agreement;Evidenca nr.106 Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët.</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të UAMD/Fakulteteve/Departamenteve/Programeve Mësimore të cilat janë në funksion të organizmit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UAMD. Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe kurrikulave, zyra e projekteve, përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshihet stafi akademik. NJSBC dhe kurrikulave është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuar nga departamentet, pjesëmarrja e lektorëve të jashtëm nga fushat specifike, trajnimet periodike të stafit akademik. Stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin si me anë të projektorëve, prezantime power point, paraqitjen e materialeve audiovizive, metoda interaktive, organizmin e leksioneve të hapura me pedagogë dhe expert të jashtëm. (<i>Evidenca nr. 11 Rregullore e NJSBC UAMD; Evidenca nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i>)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Për realizimin e procesit mësimor UAMD përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, detyra kursi, tema diplome si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti.</p> <p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperincë mjekësore dhe pedagogjike në lëndët që zhvillon.</p> <p>Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të UAMD/ Fakulteteve/ departamenteve/Programeve mësimore të cilat janë në funksion të organizmit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UAMD.</p> <p>Njësitë kryesore që asistojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë janë NJSBC dhe kurrikulave, zyra e projekteve, përmes trajnimeve dhe projekteve të vazhdueshme ku përfshihet stafi akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>x</p>

<b>Standardi III.2</b>				
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve. Të gjitha procedurat evidentohen në Rregulloret e Fakultetit të Studimeve Profesionale dhe të Departamentit të Shkencave Teknike Mjeksore Të gjitha procedurat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik, ku lektori i çdo lëndë iu shpjegon studentëve syllabuset, rregullat e provimit, mënyrën e vlerësimit dhe përqindjen përkatëse në frekuentim, aktivizim gjatë gjithë semestrit dhe prezantim e mbrojtje të detyrës së kursit.			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Kontrolli i dijeve në programin Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" bëhet në mënyrë të vazhdueshme, ai realizohet përmes dy provimeve me shkrim, i ndërmjetëm dhe përfundimtar – ku studenti përfton pikë, të cilat mblidhen dhe përkthehen në notë, sipas një tabelë të njëzuar konvertimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Provimi i ndërmjetëm përbën 40% të vlerësimit përfundimtar , detyrat e kursit 10% të vlerësimit total. Pikëve të provimit u shtohen edhe ato të vlerësimit bazuar në detyrat e kursit, projekte individualë apo në grupe, gjithashtu studentët vlerësohen edhe për praktikën profesionale. Kjo mënyrë vlerësimi jep studentit mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të Fakultetit të Studimeve Profesionale. <b>(Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD)</b>			
<b>Konkluzione</b>	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve. Të gjitha procedurat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik, ku lektori i çdo lënde iu shpjegon studentëve syllabuset, rregullat e provimit, mënyrën e vlerësimit dhe përqindja përkatëse në frekuentim, aktivizim gjatë gjithë semestrit dhe prezantim e mbrojtje të detyrës së kursit. Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, dhe i jep studentit mundësi të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>x</b>

<b>Standardi III.3</b> <b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm.</p> <p>Nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezultateve që studenti mer gjatë gjithë vitit akademik si vijon:</p> <p>Provimi i ndërmjetëm (40%)</p> <p>Detyrë kursit (ese, prezantime, projekte) detyra praktike (10%)</p> <p>Provimi përfundimtar (50%).</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me shkrim dhe / ose me gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit dhe në përputhje me specifikën e lëndës bëhet në bazë pikëzimit 0-1000 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 deri në 10.</p> <p>Forma e vetme e vlerësimit të njohurive dhe kompetencave është provimi me shkrim në të cilin përfshihen të gjithë elementët e vlerësimit të përshkruara më lart. Sistemi i vlerësimit bëhet me pikë të cilat konvertohen në notë në bazë të përcaktimeve të vendimit të senatit akademik.</p> <p>Mënyra dhe sistemi i vlerësimit ju komunikohen studentëve në fillim të procesit mësimor. Të gjitha afatet dhe datat si të provimeve të ndërmjetme ashtu edhe atij përfundimtar bëhen publike dhe përputhen më kalendari akademik të aprovuar në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD; Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP; Evidenca nr. 10 Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në provim janë të pranishëm personeli akademik i lëndës (lektori dhe asistent-lektori i lëndës) ose personeli akademik i lëndës dhe personeli akademik asistues i caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit (nëse lënda nuk ka asistent-lektor).</p> <p>Bazuar në rregulloren e Njesisë Kryesore dhe gjatë takimit me stafin evidentohet që gjatë provimit: nuk lejohet komunikimi me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të kursit; nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi; nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i kursit, përveç survejimit nga personeli akademik.</p> <p>Me qëllim rritjen e transparencës UAMD ka nënshkruar një marrvveshje me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për shtrirjen e projektit Clean Score, me qëllim familjarizimin e stafit me çështjet teknike janë realizuar kualifikimet përkatëse.</p> <p>Projekti i cili ka si objekt përdorimin e skanerave optike në korrigjimin e provimeve është shtrirë në mënyrë graduale në nivelin bachelor dhe më tej master. FSP tashmë përdor platformën e sekretarisë PITAGORA,</p>

	<p>sistem i cili rrit transparencën më studentët për të gjithë elementët e performancës së tyre në çdo lëndë.</p> <p><i>(Evidenca nr. 140 Marreveshja Clean Score; Evidenca nr. 32 Sistemi Pitagora RASH)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar realizohet nga testimi me shkrim, përmbajta dhe menyra e vlerësimit është pasqyruar dhe bazohet krejtësisht në syllabus. Komisionet e provimeve përbëhen nga të paktën dy anëtarë dhe përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Me qëllim administrimin transparent të procesit Njësia Bazë ngre grupe pune.</p> <p><i>(Evidenca nr. 88 Memo për ngritje komisioni të provimeve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente. Lektori i lëndës, në orën pasardhëse të provimit, trajton tezën e provimit për studentët duke bërë ballafaqimin e rezultateve, për të siguruar transparencën në vlerësim dhe gjithashtu për kuptuar gabimet apo boshllëqet që kanë pasur në provim. Ky është një proces shumë i rëndësishëm i cila ka një impakt real në përmirësimin e mësimnxënies dhe arrijten e rezultateve të dëshiruara.</p> <p>Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen mbi meritokracinë, studenteve rezultatet ju komunikohen në orën pasardhëse (java vijuese) pas kryerjes së provimeve të ndërmjetme dhe jo me vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p><i>(Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD ;Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP; Evidenca nr.10 Rregullore e programit të studimit; Takimi me stafin; Takimi me Studentët)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Institucioni ka politika të qarta në lidhje shmangjen e kopjimit dhe të plagjiaturës. Njësia Bazë e cila menaxhon procesin e provimeve nga zbaton protokolle të detajuara dhe precise të cilat fillojnë që nga procesi i identifikimit, firmosja e prezencës, mos përdorimi i mjeteve elektronike apo formave të tjera të kopjes etj. Gjatë tërë këtij procesi nuk lejohet të hyjë asnjë person i jashtëm.</p> <p>Institucion zbaton politika gjithashtu edhe në lidhje me plagjiaturën sit ë detyrave të kursit, process i cili realizohet nga pedagogët e lëndës, ashtu dhe për temat e diplomave të cilat kalojnë dhe kontrollohen në sistemin e kontrollit nga seksioni IT i institucionit.</p> <p>Në rast të shkeljeve të mësipërme, rregullorja e IAL përcakton penalitetet përkatëse.</p> <p><i>(Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Forma e vetme e vlerësimit është testimi më shkrim dhe rezultatet pasqyrojnë dijet dhe aftësitë profesionale të fituara. Afatet e e dhënies së rezultateve janë përcaktuar në rregulloren e FSP dhe zbatohen me korrektësi nga stafi akademik dhe drejtuesit e njësisë. Shpallja e rezultateve bëhet në sistemin Pitagora duke mundësuar edhe anonimatim ndërmjet studentëve. Pikët e provimeve të ndërmjetme kanë një afat</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut,</p>	

<p>rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>shtatë ditor ndërsa pikët e testimit përfundimtar kanë një afat prej tre ditësh pune.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studentëve iu garantohet e drejta e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Ato mund të depozitojnë kërkesën për rishikim të vlerësimit, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. <i>(Rregullorja e Universiteti "Aleksandër Moisiu")</i></p> <p>Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga Drejtuesi i Departamentit, i cili vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës. Në rastin kur kërkesa miratohet, Ai ngre një komision ad-hoc për rishikim e tezës, i cili mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij.</p> <p><i>(Evidenca nr 5 Rregullore e UAMD; Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr.10 Rregullore e programit të studimit; Takimi me stafin; Takimi me Studentët)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm ku nota përfundimtare bazohet në shumatoren e rezultateve që studenti mer gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p>Shkalla e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me shkrim dhe / ose me gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit dhe në përputhje me specifikën e lëndës bëhet në bazë pikëzimit 0-1000 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 deri në 10. Mënyra dhe sistemi i vlerësimit ju komunikohen studentëve në fillim të procesit mësimor. Të gjitha afatet dhe datat si të provimeve të ndërmjetme ashtu edhe atij përfundimtar bëhen publike dhe përputhen më kalendari akademik të aprovuar në fillim të vitit akademik.</p> <p>Me qëllim rritjen e transparencës UAMD ka nënshkruar një marrëveshje me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për shtrirjen e projektit Clean Score, i cili ka si objekt përdorimin e skanerave optike në korrigjimin e provimeve shtrirë në mënyrë graduale në nivelin bachelor dhe më tej master.</p> <p>FSP përdor platformen e sekretarisë PITAGORA, sistem i cili rrit transparencën më studentët për të gjithë elementët e performacës së tyre në çdo lëndë.</p> <p>Institucioni ka politika të qarta në lidhje shmangjen e kopjimit dhe të plagjaturës.</p> <p>Studenteve iu garantohet e drejta e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht x</p>



<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të planit mësimor të Programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" evidenton që ai synon thellimin e njohurie të marra në ciklet e mëparshme të studimit dhe zhvillon akoma me tej aftësitë profesionale të studentëve.</p> <p>Ky program zhvillohet në 1 (një) vit akademik, 2 (dy) semestra dhe ka 60 ECTS në total.</p> <p>Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta.</p> <p>1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, apo prezantime orë praktike, orë individuale.</p> <p>Kurrikula përmban 6 lëndë dhe 14 module, lëndët janë përgjedhur si lëndë profesionale të cilat zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat në fushën e infermierisë kirurgjikale në funksin të aplikimit të metodave klasike dhe të reja në sallat operatore spitalore.</p> <p>Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë të studimeve, studentët pajisen me diplomë Master Profesional me emërtimin: MP në "Infermieri Kirurgjikale".</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në këtë program studimi nuk ofrohen lëndë, module apo leksione të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit. (programi i studimit, syllabuset)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë infermierë me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike në të gjitha Specialitetet Kirurgjikale.</p> <p>Stafi akademik paraqitet i përkushtuar të realizojë të gjitha objektivat mësimore dhe formuese. Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikavë të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme. Në orën e fundit të mësimin, pedagogu përsërit si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në veçanti në temat më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët bëjnë vlerësim të vazhdueshëm dhe dinamik të lëndës përmes provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit dhe pjesëmarrjes aktive gjatë procesit mësimor.</p> <p>Gjithashtu, një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të statistikës dhe metodologjisë së kërkimit shkencor për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e veçantë në kurikulën e</p>

	<p>programit. Në përfundim të lëndëve të veçanta një vënd të rëndësishëm zë dhe diskutimi me studentët i përmbajtjes së syllabuseve, sa ju ka shërbyer ky program studimi në formimin e tyre profesional, përfundimit të aftësive dhe kompetencave në kryerjen e detyrave si dhe marrin mendimin dhe sygjërimet e studentëve për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><b>(Evidenca Nr. 123-124 Syllabuset e Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale")</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Kompetencat, të cilat synohen të fitohen gjatë ciklit të studimit janë mirëpërcaktuar në syllabuse dhe personeli akademik paraqitet krejtësisht i angazhuar për realizimi e tyre. Studentët e këtij programi kanë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme, si sallat e mirëpajisuara, laboratorët mësimorë, ashtu edhe mundësitë për të zhvilluar praktikën mësimore. Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore ka realizuar veprimtari të ndryshme, me stafin, të ftuar dhe studentët, në formën e: leksioneve të hapura nga përfaqësues të institucioneve/subjekteve të ndryshme të ftuar në auditor ose jashtë tij; vizita mësimore pranë institucioneve/subjekteve të ndryshme, GVJ vlerëson se numri dhe cilësia e këtyre aktiviteve duhet të rritet në funksion të rritjes profesionale-shkencore të stafit dhe cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Gjatë takimit me stafin akademik u vu re ai është i hapur dhe mbështet diskutimet, punën në grup me zgjidhjen dhe adresimin e prolematikave të veçanta, gjithashtu stafi u paraqit me një klimë shumë ambicioze dhe i etur për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara shkencore etj.</p> <p>Institucioni përpiqet të mbështesë stafin në nxitje të këtyre ideve, në një frymë shumë pozitive.</p> <p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit, specialitetëve kirurgjikalë apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. Një vënd të rëndësishëm në program zë praktika mësimore në laboratorët infermierorë dhe praktika profesionale në institucionet shëndetësore publike apo private ku studentët njihen praktikisht me teorinë e marrë në auditor dhe fitojnë aftësi dhe kompetencë për ushtrimin e profesionit. Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminare apo aktiviteve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese, komunikimit me etikë midis kolegëve. Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave në ndryshme në mësimdhënie, në punimin e temave të diplomës. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative,</p>

	<p>studimeve të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët në bashkëpunim me pedagogët.</p> <p><i>(Takimi me Studentet; Takimi me stafin; Evidenca nr.73 Raport mbi aktivitetet shkencore, kulturore)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre.</p> <p>Kështu Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ka një eksperiencë të mirë në angazhimin e të ftuarve të cilët zhvillojnë leksione të hapura. Fakulteti i Shkencave Profesionale zhvillon tradicionalisht një Konferencën Ndërkombëtare ndërdisiplinore. Në këtë aktivitet marrin pjesë lektorë të huaj të ftuar dhe gjithashtu ka një seksion të veçantë i dedikuar për studentët.</p> <p><i>(Takimi me Studentet; Takimi me stafin; Ev. Nr 71 Buletini aktiviteve FSP; Ev. Nr.73 Raport mbi aktivitetet shkencore, kulturore)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni, departamenti dhe FSP mbështetin studentët për zhvillimin e temave të diplomës apo studimeve. Procesi i mbrojtës së diplomës monitorohet dhe studentët trajnohen dhe asistohen në çdo hap të procesit. Gjithashtu, Institucioni krijon mundësi dhe nxit studentët për pjesëmarrje dhe organizim të aktiviteve shkencore. Kështu Institucioni ka organizuar katër konferenca ndërdisiplinore dhe tre konferenca studentore, në të cilat studentët kanë qënë si organizator ashtu edhe referues. Këto aktivitete janë financuar nga institucion duke mbështetur kështu zhvillimin shkencor dhe përparimin e tyre profesional.</p> <p><i>(Takimi me Studentet; Takimi me stafin; Evidenca Nr 71 Buletini aktiviteve FSP; Evidenca Nr.73 Raport mbi aktivitetet shkencore, kulturore)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" synon thellimin e njohurisë të marra në ciklet e mëparshme të studimit dhe zhvillon akoma me tej aftësitë profesionale të studentëve. Kurrikula përmban 6 lëndë dhe 14 module, lëndët janë përgjedhur si lëndë profesionale të cilat zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat në fushën e infermierisë kirurgjikale në funksin të aplikimit të metodave klasike dhe të reja në sallat operatore spitalore.</p> <p>Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë të studimeve, studentët pajisen me diplomë Master Profesional me emërtimin: Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</p> <p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit.</p>

	Institucioni nxit zhvillimin e studimet kërkimore-shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p><b>Studenti në fund të studimeve pajiset me diplomë Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", Diploma i jepet studentit që ka kryer të gjitha detyrimet e programit mësimor dhe detyrimet e tjera të UMAD si dhe mbrojtur mikrotezën/ provim të përgjithshëm përfundimtar/formimi.</b></p> <p>Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Studentët të cilët nuk marrin tezë diplome, i përfundojnë studimet me provim të përgjithshëm përfundimtar/formimi.</p> <p>Rregullorja e diplomit mbart informacione të detajuara dhe specifike për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e UAMD dhe të programit të studimit.</p> <p>Njësia Bazë vë në dispozicion të studentëve fushat e studimit dhe gjithashtu listën e stafit akademik nga e cila duhet të zgjidhen udhëhëqësit e temave. Studenti paraqet me shkrim kërkesën e tij dhe Njësia Bazë pasi shqyrton kërkesat bën klasifikimin e studentëve të cilët përmbushin kriteret dhe përcakton temat e diplomës dhe udhëhëqësit akademik përkatës.</p> <p>Student të cilët i mbyllin studimet me anë të provimit final i referohen rregullorës përkatëse për sa i përket kushteve siç janë detyrimet financiare, mbyllja e detyrimeve akademike, mbylljen me sukses të praktikës profesionale. Të gjitha procedurat e mësipërme janë pjesë e dokumentacionit të institucionit dhe bëhen publike.</p> <p><i>(Evidenca Nr. 97.1 Rregullore diplomimi/Mikroteza dhe rregullore e provimit final. Evidenca Nr. 127 Udhëzimi i Koordinatorit të Masterit për Vlerësimin e Provimit Final të Masterit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Fokusi i programit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", është përvetësimi i aftësive teorike dhe praktike profesionale nga ana e studentit.</p> <p>Bazuar në këtë qëllim zgjedhja dhe përpunimi i temës së diplomës si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar</p>

	<p>njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme studimore. Udhëheqësi shkencor siguron që studenti të marrë mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për të kryer punë kërkimore të suksesshme individuale. Udhëheqësi e asiston studentin gjatë përgatitjes së strukturës së punimit, rekomandon literaturën dhe ka përgjegjësi ta ndergjegjësojë studentin për rrezikun e falsifikime dhe të plagjaturës.</p> <p>Gjithashtu, Njësia Bazë për studentet të cilët mbyllin studimet me provim final afishon listën e lëndëve dhe më përqindjet përkatëse që do të jenë pjesë e provimit 3 muaj përpara afatit të mbarimit të masterit. Të gjitha kriteret dhe standartet gjenden në rregulloren e diplomimit.</p> <p><b>(Evidenca Nr.97.1 Rregullore diplomimi/Mikroteza dhe rregullore e provimit final ;Evidenca Nr. 141 kopje e tezës së diplomimit)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisioni të propozuar nga departamenti dhe miratuar nga Dekani i Fakultetit. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, nga një Komisioni i përbërë lektorë të Departamentit të Shkencave Teknike Mjekësore.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar llogaritet si mesatare e notave të dhëna nga çdo anëtar i komisionit.</p> <p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar është konceptuar si përmbledhje dhe eksplorim i njohurive të dhëna gjatë tërë periudhës së studimit dhe duke e organizuar në varësi të peshës specifike të lëndëve dhe moduleve. Lëndët dhe përqindjet përkatëse shpallen siç u tha më lart 3 muaj përpara përfundimit të studimeve. Gjatë provimit final njësia bazë përgatit 8 teza nga të cilat studentët zgjedhin katër. Korrigjimi dhe shpallja e rezultateve realizohet brenda të njëjtës ditë.</p> <p><b>(Evidenca Nr. 97.1 Rregullore diplomimi/Mikroteza dhe rregullore e provimit final)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët, ndihma e të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave konsultuese që janë orë pune që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, <b>përpilimin e protokolleve</b>, shkrimin apo prezantim e punimit të diplomës. Seancat konsultuese zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë karakter interaktiv.</p> <p>Udhëheqësi mban takime të rregullta me diplomantin dhe vlerëson progresin e tij duke i kërkuar të paraqesë nje raport të shkruar duke monituar në këtë menyrë progresin.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p><b>Në fund është udhëheqësi ai që aprovon paraqitjen e temës para komisionit</b></p> <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe dhe vë në dispozicion së bashku me partnerët bashkë punues mjedisët dhe</p>

	<p>mjetet e nevojshme për realizimin e pjesës eksperimentale të temës së diplomës me qëllim mbledhjen, evidentimin, përpunimin e të dhënave të nevojshme, apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><b>(Evidenca Nr. 97.1 Rregullore diplomimi/Mikroteza dhe rregullore e provimit final; Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës udhëzon dhe orienton studentin gjatë punimit të temës, mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e rezultateve, literaturën që do shfrytëzoj dhe jep miratimin me shkrim nëse studimi është i plotë për tu paraqitur përpara komisionit të vlerësimit. Studenti dorëzon dy kopje të punimit të diplomës në formë fizike, elektronike dhe Power Point. Mbrojtja bëhet përpara komisionit të caktuar nga të miratuar nga Njësia Bazë përgjegjësi i departamentit. Vlerësimi bëhet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimi bazohet në disa kritere si cilësia e punimit, struktura organizmit, shkrimi mënyra e zhvillimit të ideve, cilësia e analizës dhe rezultateve të studimit, mënyra e paraqitjes, literaturë etj. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UMAD-it dhe ka përmbushur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me çertifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UMAD, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani.</p> <p><b>(Evidenca nr. 120 Suplementi i diplomës së Master; Evidenca Nr. 119 Diploma Master )</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhen nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar në hard-copy dhe në databazë digjitale e cila funksionin sipas nenit 24 të rregullores së arkivimit të dokumentave. Institucioni mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Kështu Institucioni bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe Legjislacionit në fuqi disponon një databazë të plotë të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, ASCAL.</p> <p><b>(Evidenca Nr.20 Rregullore për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD; Evidenca Nr 12 Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe informacionit)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Studenti në fund të studimeve pajiset me diplome Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", Diploma i jepet studentit që ka kryer të gjitha detyrimet e programit mësimor dhe detyrimet e tjera të UMAD si dhe mbrojtur mikrotezën/ provim të përgjithshëm përfundimtar/formimi.</p>

	<p>Rregullorja e diplomit mbart informacione të detajuara dhe specifike për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e UAMD dhe të programit të studimit</p> <p>Udhëheqësi shkencor siguron që studenti të marrë mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për të kryer punë kërkimore të suksesshme individuale. Udhëheqësi e asiston studentin gjatë përgatitjes së strukturës së punimit, rekomandon literaturën dhe ka përgjegjësi ta ndergjegjësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjaturës.</p> <p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UMAD-it dhe ka përmbyllur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare në UMAD, me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani.</p> <p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhen nga institucion për një afat kohor të pacaktuar në hard-copy dhe në databazë digjitale.</p>			
Shkalla e përmbylljes sëstandardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				x

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore me qëllim zbatimin e njohurive teorike dhe fitimin e aftësive praktike kanë vënë në dispozicion të studentëve brenda institucionit katër laboratore infermiore. Në këto laboratore studentë aplikojnë të gjitha procedurat inferiore të mësuara në pjesën teorike.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Laboratori i kirurgjisë është ndërtuar dhe dedikohet posaçërisht studenteve të programit e e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", në këtë laborator ato praktikojnë që nga përgatitjet preoperatorë deri në proceset e asistencës së kirurgut. Në këtë laborator organizohen kurse saturimi, kurse shumë të rëndësishme këto për rritjen e kompetencave profesionale të studentëve.
<b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	UMAD ka garantuar kryerjen e praktikës profesionale në institucione shëndetësore publike në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me to duke ju krijuar mundësi studentëve të fitojnë shprehitë të punës praktike dhe të familjarizohen me to si dhe të krijojnë kontakte me stafin mjekësor dhe infermior duke bërë të mundur dhe realizimin e mikrotezës së diplomës. Për realizimin e praktikës profesionale institucioni, ka lidhur marrëveshje me institucione shëndetësore publike si Spitalin Rajonal

	<p>Durrës, QSUT, Qendrën Vullnetare të Emergjencës Civile duke ju siguruar studentëve që të kryejnë praktikën profesionale në institucione shëndetësore. IAL ka nënshkruar 14 marrveshje bashkëpunimi dhe një nga institucionet më të rëndësishme është Spitali Rajonal i Durrësit, ku stafi akademik përgjigjet për praktikën raporton vazhdimisht të koordinatori i programit në lidhje me tërë mbarvajtjen e praktikave. Praktikën organizohet në bazë të një grafiku i cili zbatohet dhe ndiqet paralelisht nga të dy Institucionet.</p> <p>Në Programin e Studimit Master Profesional “Infermieri Kirurgjikale”, praktikën profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluar përgjatë studimeve lëndore vlerësohen me notë dhe kredite, njësoj me disiplinat e tjera të Masterit Profesional “Infermieri Kirurgjikale”.</p> <p>Praktika profesionale ka 6 kredite dhe zhvillohet në semestrin e dytë. Mënyra e organizimit të praktikës përcaktohet në rregullore dhe tematikat përcaktohen në syllabusin përkatës. Praktika organizohet në grupe me jo më shumë se 5 studentë me një grafik të përcaktuar dhe zgjat për një periudhë jo më pak se tre muaj.</p> <p>Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës dorëzon tek Koordinatorja e Departamentit formularin e vlerësimit të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi i institucionit ku ka kryer praktikën profesionale, dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës. Në këtë format përfshihet edhe një praktikë infermierore e përzgjedhur e cila vlerësohet më 10% të notës përfundimtare.</p> <p>Pas dorëzimit të formularit studenti duhet të mbrojë dhe prezantojë raportin e praktikës para një komisioni i cili ngrihet nga departamenti. Vlerësimi i praktikës profesionale bëhet si për të gjitha lëndët që studenti ka realizuar gjatë programit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 121 Dosja e programit të studimit; Evidenca nr. 124 Syllabusi i praktikës profesionale; Evidenca nr. 94 Marrveshje Bashkëpunimi; Evidenca nr 128 format i Procedurës Infermierore)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore me qëllim zbatimin e njohurive teorike dhe fitimin e aftësive praktike kanë vënë në dispozicion të studentëve brenda institucionit katër laboratore infermierore.</p> <p>UMAD ka garantuar kryerjen e praktikës profesionale në institucione shëndetësore publike në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me to duke ju krijuar mundësi studentëve të fitojnë shprehitë të punës praktike dhe të familjarizohen me to si dhe të krijojnë kontakte me stafin mjekësor dhe infermieror duke bërë të mundur dhe realizimin e mikrotezës së diplomës.</p> <p>Praktika profesionale ka 6 kredite dhe zhvillohet në semestrin e dytë. Mënyra e organizimit të praktikës përcaktohet në rregullore dhe tematikat përcaktohen në syllabusin përkatës.</p>






	Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës dorëzon tek Koordinatorja e Departamentit formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi i institucionit ku ka kryer praktikën profesionale, dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht x

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Departamenti përgjegjës i programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore (DSHMT). Personeli akademik dhe ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, kanë formimin e duhur profesional dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Në tre vitet akademike 2021-2023 përbërja e stafit akademik është si vijon:</p> <p>Për vitin 2020 -2021 Stafi akademik përbëhet nga 67(gjashtëdhjetëeshtatë) staf akademik, prej të cilëve 15 (pesëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 52(pesëdhjetëedy) PAK. Nga PAE 9(nëntë) janë Doktorë shkencash dhe 6(gjashtë) Msc. Nga PAK 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 10 (dhjetë) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 40(dyzetë) Msc. Në përbërje të Departamentin janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me Msc.</p> <p>Për vitin 2021-2022 Stafi akademik përbëhet nga 68(gjashtëdhjetëetë) staf akademik, prej të cilëve 15 (pesëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 53(pesëdhjetëtre) PAK. Nga PAE 9(nëntë) janë Doktorë shkencash dhe 6(gjashtë) janë Msc. Nga PAK 3(tre) janë të kategorisë Profesor, 11(njëmbëdhjetë) janë me gradën Doktor Shkencash dhe 39 (tridhjetëenëntë) Msc. Në përbërje të Departamentin janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me Msc.</p> <p>Për vitin 2022-2023 Stafi akademik përbëhet nga 65(gjashtëdhjetepesë) staf akademik, prej të cilëve 16 (gjashtëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 49(dyzetenëntë) PAK. Nga PAE 10(dhjetë) janë Doktorë</p>

	<p>Shkencash dhe 6(gjashtë) janë Msc. Nga PAK 1(një) është i kategorisë Profesor, 11(njëmbëdhjetë) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 36(tridhjetëegjashtë) janë Msc. Në përbërje të Departamentin janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me Msc</p> <p>Në tre vitet e fundit vihet re që numri i stafit akademik është stabil, rritje të cilësisë të stafit akademik të ftuar, ndërsa raporti PAE/PAK varion nga 15/53 në 16/49, duke mos qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p><b>GVJ rekomandon përmirësimin e këtij raporti në favor të stafit akademik efektiv.</b></p> <p><i>(Evidencë 130 Të dhënat tabelore per stafin akademik ne programin e studimit MP në "Infermieri Kirurgjikale", Evidenca Nr.122 CV e stafit akademik të jashtëm të programit të studimit. Evidenca Nr.81 CV të Stafit Akademik dhe Ndhmës Akademik të DSHTM. Evidenca 75 Të dhënat tabelore për personelin akademik të DSHTM)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e programit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Pjesë e stafit të programin është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor me formimin e duhur profesional, cili është përgjegjës për organizimin e praktikave mësimore dhe asiston pedagogët në realizimin e tyre si dhe studentët në praktikimin e procedurave të ndryshme. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor në këtë program studimi, formimi i tyre profesional, për tre vitet akademike 2020-2023.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit MP në Infermieri Kirurgjikale është si vijon :</p> <p>Për vitin 2020-2021 stafi akademik përbëhet nga 11(njëmbëdhjetë) staf akademik, prej të cilëve 6 (gjashtë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 5(pesë) PAK. Nga PAE 1 (një) është i kategorisë Profesor, 2(dy) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 2(dy) janë Msc dhe 1(një) në proces doktorature. Nga Stafi akademik PAK 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 2(dy) janë Doktor Shkencash dhe 1(një) është Msc</p> <p>Për vitin 2021-2022 stafi akademik përbëhet nga 11(njëmbëdhjetë) staf akademik, prej të cilëve 6 (gjashtë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 5(pesë) PAK. Nga PAE 1 një është i kategorisë Profesor, 3(tre) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 2(dy) janë Msc. Nga Stafi akademik PAK 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 2(dy) janë Doktore Shkencash dhe 1(një) është Msc .</p> <p>Për vitin 2022-2023 stafi akademik përbëhet nga 11(njëmbëdhjetë) staf akademik, prej të cilëve 9 (nëntë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 2(dy) PAK. Nga PAE 1 një është i kategorisë Profesor, 6(gjashtë) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 2(dy) janë Msc. Nga Stafi akademik PAK 1(një) është i kategorisë Profesor, 1(një) është Doktore Shkencash .</p> <p>Në përbërje të programit të studimit janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik/laborant me karakter mësimor me Msc</p>




	<p>Stafi akademik ka formimin dhe edukimin e duhur profesional për realizimin e programit mësimor.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ konstaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet lëndë që ata zhvillojnë në programin e studimit.</p> <p>Referuar evidencës mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik konstatojmë se për 3 vitet akademike 60-70 % e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi akademik efektiv. <b>Raporti PAE/PAK është 6/5 në vitet 2020-2022, ndërsa në vitin akademik 2022-2023 ky raport është përmirësuar në 9/2.</b> Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se ka mospërputhje të informacionit të paraqitur në evidencën 130 me evidencën Tabela ASCAL MP Infermieri Kirurgjikale.</p> <p>Mosha e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit është relativisht e re dhe pjesa më e madhe e stafit akademik është në grup moshën 36-55vjeç. <b>GVJ rekomandon institucioni të marra masa që stafi akademik efektiv të realizoj mbi 70% të ngarkesës mësimore.</b></p> <p><b><i>Evidenca nr.122. CV-të e stafit akademik dhe ndihmës të programit tëstudimit.</i></b></p> <p><b><i>Evidenca nr.130 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion e shqyrtuar në drejtorinë e burimeve njerëzore, Departamentit, ku zhvillohet program i studimit si dhe CV e stafit akademik konstatojmë se në tre vitet e fundit stafi akademik është stabil.</p> <p>GVJ evidenton që gjatë këtyre viteve PAE është rritur në numër dhe cilësi, ndërsa në PAK ndryshimet janë të mëdha në vitin 2022-2023 ku vërehet shtim të stafit akademik efektiv dhe ulje të PAK. Nga shqyrtimi me sondazh i kontratave të punës konstatojmë se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><b><i>(Evidenca Tabelat ASCAL dega mastër profesional Infermieri)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë.</p> <p>Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UAMD. Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme realizohen nga njesia bazë duke propozuar komisione Ad-hoc konform bazës ligjore dhe nënligjore si dhe akteve të brendshme rregullatore të UAMD. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve</p>

	<p>bëhet me sistem pikëzimi. Nga shqyrtimi me sondazh i dosjeve të personelit GVJ konstatohet se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar.</p> <p><b>Konkretisht dosja e stafit akademik përmban:</b>      Formulari i aplikimit (ose kërkesë për riaplikim)      Diploma e studimeve      Liçenca e ushtrimit të profesionit      Karta e identitetit      Vërtetim nga fakulteti      Çertifikata trajnimesh dhe pjesëmarrje në konferenca      Rekomandim</p> <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuara nga UAMD dhe kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Bazuar në statusin e UAMD dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedurë dhe kritere për rekrutimin e personelit.</p> <p>Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe atë vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevojë për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik për realizimin e programit të studimit, dekanati i përcjellë në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e Web-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidati, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit.</p> <p>Pas shpalljes së vendit vakant, dekani ngrë komision "ad hoc" që do të realizojë procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurrimi kalon në dy faza:</p> <p><b>Vlerësim në bazë të dosjes</b>  <b>Intervista gojore</b></p> <p>Kur një dosje skualifikohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 5 ditësh duhet të bëjë ankimim me shkrim nëse ka. Për çdo fazë vlerësimi pritet 5 ditësh pas shpalljes së vlerësimit për ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisionit i përcillet rektoratit, i cili harton kontratën e punës në bazë të kodit të punës dhe legjilacionit në fuqi. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim, Institucioni realizon vlerësim të vazhdueshëm duke shfrytëzuar zhvillimin e pyetësorëve të studentëve dhe formularët e vetëvlerësimit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.82 Procedura e rekrutimit.)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentohet angazhimi i personelit ndihmës akademik, asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirëmbajtjen e laboratorëve mësimorë.</p> <p>Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij.</p> <p><i>(Evidenca tabelat ASCAL dega MP Infermieri Kirurgjikale)</i></p>




<p>mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se UAMD, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale". Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër si dhe dosjen personale për staf jo akademik. Në regjistrin themeltar të stafit hidhen të dhënat si : data e fillimit të punësimit, ndryshimet e vendit të punës nqs ka, deri në largimin dhe tërheqjen e librezës së punës nga individ. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësime në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka venë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre. Gjithashtu, GVJ evidentoi që çdo fillim viti akademik, pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit evidencat e realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky i koordinuar nga Drejtuesi i Departamentit, Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike</p> <p><i>(Evidenca Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale, Evidenca Nr.09 Rregullore e Departamentite Shkencave Teknike Mjekësore, Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit MP Infermieri Kirurgjikale; Evidenca Tabelat ASCAL dega MP Infermieri Kirugjikale, Evidenca nr. 20 Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSP dhe UAMD garanton mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpajisura brenda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione. Konkretisht GVJ evidentoi që UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe sic janë Spitali Rajonal Durrës, Qendra Spitalore Univeristare "Nënë Tereza" Tiranë, Qendra Shëndetësorë 1 dhe 6 Durrës, Klinika Edar medical, Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Shoqata e infermirëve të Shqipërisë etj. Marrëveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale si dhe realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Instucional dhe zbatohen nga njësia bazë.</p> <p>Praktika e detyrueshme, mbikëqyret bashkarisht nga mbikqyresi në vendin e praktikës (një infermiere e dedikuar) dhe anëtari i caktuar nga stafit akademik i departamentit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.94 Marreveshtjet e Bashkëpunimit të DSHTM, Evidenca Nr.96 Tabela me Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FSP, Evidenca Nr.136</i></p>

	<b>Grafiku i praktikave spitalore të studenteve, Evidenca Nr.102 Rregullore e laboratoreve. Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit MP Infermieri e përgjithshme.)</b>			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p>Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave profesionale që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marrëveshjeve të lidhura.</p> <p>Praktikat profesionale të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" realizohen në Spitalin Rajonal Durrës dhe janë të shpërndara sipas grafikut të organizuar nga lektori i praktikave në bashkëpunim me përfaqësuesin e Spitalit Rajonal Durrës. Praktika realizohet në semestrit e dytë, gjate fundjavës, 14 orë praktike në javë për 3 muaj. Personeli mbikqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve, raportit përfundimtar të praktikës gjithashtu dhe në vlerësimin e tyre. Personeli infermieror i cili ndjek praktikat profesionale në spital bashkëpunon ngushtë me stafin akademik të departamentit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit MP në Infermieri Kirurgjikale" Evidenca . Udhëzuesin për kryerjen e Praktikave.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>-Për realizimin e programit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", IAL ka angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc.</p> <p>- 60-70 % e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi akademik efektiv.</p> <p>- Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet me lëndë që ata zhvillojnë në programin e studimit.</p> <p>-UAMD, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".</p> <p>-Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSHMT dhe UAMD garanton mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura mirë brenda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			x	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

**Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

Gjatë vizitës në instucion GVJ u njoh më mjediset e UAMD. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, zhvillon procesin mësimor në tre godina, një në Currila dhe dy në Kampusin Universitar, Spitalë. Fakulteti i Studimeve Profesionale zhvillon procesin mësimorë dhe veprimtarinë akademike në Godinën e Currilave në Godinën Nr. 1, Kampusi Universitar, Spitalë.

Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin të mirë pajisura, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme.

Fakulteti i Studimeve Profesionale, ka 18 auditorë me kapacitet total 1316 vende dhe me sipërfaqe totale 1644.5 m<sup>2</sup>, 7 laborator me 352 vende me sipërfaqe 575.6 m<sup>2</sup>, 13 zyra me sipërfaqe totale 362.88 m<sup>2</sup>, sallë konferencash me kapacitet 280 vende dhe me sipërfaqe prej 380 m<sup>2</sup>. Gjithashtu disponon Bibliotekë me sallë leximi me një kapacitet 30 vende me sipërfaqe totale 120 m<sup>2</sup>.

Auditorët kanë hapësira të mjaftueshme, të ndriçuara dhe me sistem ngrohje/ftohje. Është në fazën e testimit sistemi wireless në disa ambiente të Fakultetit të Studimeve Profesionale. Kjo risi krijon kushte të mira për përmirësimin e teknikave të mësimdhënies, ndërkohë që sistemi kabllor i shpërndarjes së internetit është në të gjitha ambientet. Njësia bazë ka në dispozicion mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Organizimi i orarit mësimor është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.

*(Evidenca nr. 42 dhe 42.1 Ambiente të Fakultetit të Studimeve Profesionale Evidenca nr. 69 Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së)*

<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të posteve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe në raport me numrin e posteve në sallë. Ambientet mësimore janë me sistem kondicionimi ngrohje dhe ftohje. Ambientet e FSP kanë nje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, të cilat u konstatuan dhe gjatë vizitës on line në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve. Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Në funksioin të programit janë në dispozicion mjete elektronike audiovizive dhe teknologjise së informacionit, si kompjutera, whiteboard,videoprojektorë, kryesisht në sallat e leksioneve, wireless. Ndrichiimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Në ambientet e fakultetit ku zhvillohet programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", gjenden laboratorët e infermierisë, laborator i kirurgjisë, në të cilin zhvillojnë leksione të integruara me praktikën për studentët. <i>(Vizita e ambienteve, Evidenca nr. 69 Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>FSP zotëron laboratorët mësimor modern në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e SHMT apo departamante të tjera të FSP. Laboratori i infermieristikës është i paisur me mulazhe që stimulojnë limdjen, ku studentët kryejnë dhe teknikat apo procedura të ndryshme infermierore si injeksione, qepje plagësh, mjekime etj. Gjithashtu në këtë laborator gjënden manikina apo krahë mulazhi për injeksionet intravenoze dhe lloje të ndryshme kateteri, ku studentët mësojnë në mulazhe vendosjen e katetereve dhe kryerjen e injeksioneve venoze. Laboratori ka elektrokardiogramën dhe aparatura e matjeve të shenjave vitale/monitor, ku studentët mësojnë si të kryejnë një elektrokardiogramë dhe të vendosin dhe monitorojnë shenjat vitale të pacientit. Mjediset janë të ndriçuara dhe të pajisura me kapacitete ngrohëse e ftohëse gjatë gjithë vitit. Ato janë funksionale gjithmonë Në dispozicion të studenteve të programit studimit Bachelor në Mami janë dhe Laboratorët në varësi të departamenteve të tjera të FSP. <i>(Evidenca Nr.101 Raport mbi laboratoret e DSHTM., Evidenca nr. 102 Rregullore e laboratoreve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit në Master Profesional ne Infermieri kirurgjikale është laborator i teknologjisë së Informacionit. Laboratori është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale që përdoren nga studentët pa pagesë për qëllim mësimi apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë</p>



	<p>të pajisura me videoprojektor dhe me mundësi për të aksesuar sistemin wireless të internetit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 58 Vleresimi i kapaciteteve të UAMD-së, Evidenca nr. 42.1 Ambiente të FSP, Evidenca Nr.101 Raport mbi laboratorët e DSHTM).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale në këtë program studimi, institucioni ka infrastrukturën e nevojshme në FSP ku në dispozicion të programit të studimit janë laboratorët e infermierisë dhe laboratorët e kirurgjisë për aftësimin profesional dhe familjarizimin e studentëve me praktikën infermirore kirurgjikale. gjithashtu për realizimin e praktikave kirurgjikale FSP ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe private spitalore dhe shërbim parësor, ku studentët kryejnë praktiken profesionale sipas një grafiku të miratuar. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Institucional dhe zbatohen nga njësi bazë.</p> <p><i>(Evidenca 94 Marrëveshjet e bashkëpunimit DSHTM, vizita e ambienteve në institucion.)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standardeve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</p> <p>-FSP zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e SHTM apo departamente të tjera të FSP si dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore për realizimin e praktikës profesionale.</p> <p>-Laboratori i infermieristikës është i pajisur me mulazhe që stimulojnë lindjen, ku studentët kryejnë dhe teknikat apo procedurat infermirore gjatë lindjes normale, manikina apo krahë mulazhi për injeksionet intravenoze dhe lloje të ndryshme kateteri, ku studentët mësojnë vendosjen e katetereve dhe kryerjen e injeksioneve venoze; ka elektrokardiogramën, aparaturnë e matjeve të shenjave vitale/monitor, kryerjen e mjekimit të plagëve apo qepje të tyre.</p> <p>-Në funksion të programit të studimit në Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është laboratorët e teknologjisë së Informacionit i cili është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për që përdoren nga studentët pa pagesë për qëllim mësimor apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>x</p>

**Standardi IV.3**

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë program studimi/syllabuset se pjesa më e madhe e lëndëve në këtë program studimi nuk kanë tekste por leksione të shkruara nga pedagogët, tekstet në disa lëndë janë të vjetëruara.</p> <p><b>GVJ rekomandon hartimin e teksteve mësimore bazë në gjuhën shqipe dhe përditësimin e literaturës bazë. Shtimin e literaturës mjekësore bazë të viteve të fundit në bibliotekë.</b></p> <p><i>(Evidenca nr. 49 Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD Evidenca nr. 50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me Stafin Drejtues, u deklarua që çdo fillim viti akademik titullari i lëndës/ pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi një numër të lartë të titujve, literatura mjekësore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar. I njëjti fenomen u evidentua gjatë gjatë shqyrtimit të kurrikulave, GVJ evidentoi që literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar dhe në pjesën më të madhe të lëndëve bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët.</p> <p>Në takimin me stafin akademik u theksua se çdo vit akademik paraqiten kërkesa për tekste dhe literaturë mjekësore dhe parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore, por nga Institucioni nuk është realizuar procedura e blerjes.</p> <p><b>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogeve dhe stafit administrativ dhe drejtues të FSP dhe UAMD, për realizimin e procedurave të blerjes me qëllim pasurimin e metejshëm të fondit të bibliotekës.</b></p> <p><i>(Evidenca nr. 62 Raporti financiar UAMD, Evidenca Nr.50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit. Evidenca Nr.49 Lista e Teksteve në Bibliotekën e UAMD)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka 3 biblioteka, një është pranë pranë Godinës në Currila që është biblioteka qendrore, biblioteka pranë Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit e cila është e vendosur në mjediset e godines A e ndodhur në Spitalë edhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave PolitikoJuridike e vendosur në godinën B, Spitalë. Çdo bibliotekë ka hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Mjediset e bibliotekave kanë kapacitete në</p>

	<p>tituj dhe pajisje si kompjutera për të mundësuar plotësimin e kërkesave të tyre. Numri i titujve fizikë në fond është 12000, numri i teksteve mësimore 2500, artikujt shkencorë mbi 4000 dhe librat elektronikë mbi 30. 000. Ambientet e bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë.</p> <p><i>(Evidenca Nr.48 Informacione per bibliotekën UAMD, Vizita e ambienteve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Universitetit dhe ajo në fakultetet është e paisur me tekste universitare, libra e revista në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka një fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra elektronikë.</p> <p><b>Megjithatë GVJ rekomandon që ajo duhet të pasurohet më tej me botime te fundit dhe me tituj të rinj në fushën e shkencave mjekësore.</b></p> <p><i>(Evidenca Nr.48 Informacione për bibliotekën UAMD, Evidenca nr. 51 Manual biblioteke online, Vizita e ambienteve)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. UAMD ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Kapacitet e bibliotekës ofrojnë 126 vende, kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi aksesit në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e mamisë për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektet e tyre. Nga ana tjetër të gjitha punimet, materialet didaktike, librat universitar duhet të depozitohen në bibliotek, duke e pasuruar më shumë atë. Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisu" përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë: COBIB.AL</p> <p><i>(Evidenca nr. 52 Biblioteka Online te dhena mbi materialet e disponueshme, Evidenca nr. 53 "Digital Library" – UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu, UAMD ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. Biblioteka është e pajisur me programe të integruara bibliotekare: COBIS. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik, me standard ndërkombëtare i cili ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit si dhe falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të UAMD-së. Gjithashtu biblioteka ka marrëveshje dhe me biblioteka të tjera si Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, "Kompaninë Koral Inc E cila siguron përfshirjen e studentëve dhe stafit në platformën e-learning, Shoqatën Shqiptare të Bankave B që sigurojnë falas botimeve të ASB-së, Interdisciplinary Journal of Research and Development (14 numra) etj</p>

	<i>(Evidenca Nr.53 Digital Library - UAMD. Evidenca Nr.54 Lista e paketave U-Library. Evidenca Nr.55 Kalendari bibliotekës në fundjavë.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 8. <sup>00</sup> -19 <sup>00</sup> cdo ditë të javës, si dhe gjatë fundjavës, orare këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Studentët pajisen me kartë regjistrimi, Institucioni ka planifikuar gjithashtu pajisjen me karta elektronike. <i>(Evidenca Nr.55 Kalendari bibliotekës në fundjavë)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	UAMD planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekse vijnë nga departamente e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e tekseve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Në takime me stafin akademik dhe në RVB theksohet se megjithëse çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore, në shumicën e rasteve këto fonde nuk janë realizuar dhe nuk janë zbatuar nga institucioni. <i>(Evidenca nr. 50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit, Evidenca nr. 62 Raport financiar UAMD)</i>
<b>Konkluzione</b>	-UAMD ka 3 biblioteka, një është pranë pranë Godinë së Currila që është biblioteka qendrore, biblioteka pranë Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit e cila është e vendosur në mjediset e godines A e ndodhur në Spitallë edhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike e vendosur në godinën B, Spitallë. -Oraret e shërbimit të bibliotekës ofroheshin sipas një kalendari të miratuar dhe të afishuar në ambientet e bibliotekës. -Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit. -Për këtë program studimi literatura bazë për pjesën më të madhe të lëndëve janë leksione të shkruara nga pedagogu i lëndës. -Biblioteka në UAMD siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line ku studentet mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. -Biblioteka është e pajisur me programe të integruara bibliotekare si COBIS. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik, me standard ndërkombëtare i cili ofron një version të avancuar në kërkimin e informacion si dhe falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të UAMD-së.

	<p>- Biblioteka ka marëveshje dhe me biblioteka të tjera si Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, "Kompaninë Koral Inc E cila siguron përfshirjen e studentëve dhe stafit në platformën e-learning, Shoqatën Shqiptare të Bankave që sigurojnë falas botimeve të ASB-së, Interdisciplinary Journal of Research and Development (14 numra) etj -Pamvarësisht numri të lartë të titujve, literatura mjekësore ishte e varfër në tituj dhe e vjetëruar. <i>Rekomandojmë pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogeve dhe stafit administrativ dhe drejtues të UAMD.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			x	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UAMD disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin ESSE3. Sekretaria mesimore dokumentacionin e ruan në dy forma shkruese dhe elektronike. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Studentët e regjistruar pajisen me librezë student.</p> <p>Sekretaria mësimor ka në formë shkruese:</p> <p>Rregjistri themelator të studentëve</p> <p>Rregjistri me të dhënat akademike</p> <p>Rregjistri i lëshimit të diplomave</p> <p>Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon :</p> <p>Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës</p> <p>Proçes verbalet e testime në provime.</p> <p>Dosjet e diplomimit;</p> <p>Dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçes verbalet e notave të provimit/temave të diplomës</p>

	<p>listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra.</p> <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit. Të gjitha opsionet e mundshme janë të përcaktuara në manualin e përdorimit të sistemit UMS nga secili prej përfituesve të tij .</p> <p><i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, Evidenca nr. 9 Rregullore e DSHTM, Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit të Teknologjise së Informacionit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik , ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores përkatëse. Stafi akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin ESSE3, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njëjës kryesore (fakultetit) pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik dhe administrative, programet e studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifën e studentëve dhe pagesat e kryera. Institucioni disponon sistemin e tij elektronik të të dhënave ESSE3 dhe një rregullore të funksionimit të tij. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentet, stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studenteve dhe stafit akademik (PAE dhe PAK) adresat e emailit zyrtar (@uamd.edu.al), i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional, dhe të jashtëm.</p> <p>Informacion në lidhje me veprimtarinë e stafit akademik ruhet edhe nëpërmjet akaunteve që stafi ka në portalin e UAMD-së, informacion që ka karakter informues për publikun e gjerë apo sistemin ESSE3, ku mund të ruhet dhe analizohet marrëdhënia e stafit me studentin në terma të vlerësimit për lëndët ku pedagogu është koordinator.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, , Evidenca nr. 70 Analiza vjetore FSP, Evidenca nr. 16 Rregullore baza e të dhënave për kërkimin shkencor, Evidenca nr. 23 Programi i Transparencës së UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Siç u theksua më lart çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Sistemi ESSE3 ka të përfshirë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve. Një vend</p>

	<p>të rëndësishëm zë edhe shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky informacion dokumentohet në stenda dhe web-in e Universitetit me seksion të veçanta për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit.</p> <p>Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar sistemin Pitagora ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentit. Përmes këtij sistemi studenti merr në kohë reale të dhëna në lidhje me të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, informacionit në lidhje me vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare.</p> <p><i>(Vizita në institucion, Evidenca nr. 32 Sistemi Pitagora (Rash), Evidenca nr. 100 Njoftimet në rrjete sociale të FSP, Evidenca nr. 131 Njoftime me e-mail për Studentet e mamisë, Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultate etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikën që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem.</p> <p><i>Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UAMD, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UAMD dhe fakultete, stafin akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, bazën ligjore që funksionin UAMD, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj. Portali i UAMD-së shërben si një platformë ku studenti mund të marrë informacion në websit-et e pedagogëve për materiale të ndryshme në lidhje me lëndë specifike. Çdo pedagog është i detyruar të vendose në 2 gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.</p> <p><i>(Evidenca nr. 31 Print screen faqja e UAMD-së)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>UAMD disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin ESSE3.</p>

	<p>-Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët, çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit.</p> <p>-Portali i UAMD-së shërben si një platformë ku studenti mund të marrë informacion në webin e pedagogeve për materiale të ndryshme në lidhje me lëndë specifike.</p> <p>-Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar sistemin Pitagora ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentit.</p> <p>-Faqja zyrtare UAMD përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare në web është në dy gjuhë: shqipe dhe angleze.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik UAMD harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Hartimin e këtij plani e realizon Drejtoria Financës dhe buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Fondet burojnë nga buxheti i shtetit, të ardhurat e universitetit nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë si dhe tarifën e studentëve. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në çdo fillim viti akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr. 62 Raport financiar i UAMD, Evidenca nr. 63 Plani Financiar Vjetor i Fakultetit të Studimeve Profesionale, Evidenca nr. 67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; Evidenca Nr.68 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit (kostot e programit MP INF).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për</p>	<p>Çdo vit akademik FSP në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifën e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifën e shkollimit për çdo program bazuar në VKM 638 datë 22.07.2015. Tarifën e shkollimit nuk e kalojnë koston e programit të studimit. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifën e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe</p>



<p>bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese. Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga MAS dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditimi vlerëson aktivitetin financiar të institucionit. GVJ nuk gjeti kopje të Auditimit të UAMD.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit i cili është i aksesueshëm dhe në faqën zyrtare të institucionit <a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare (grante, projekte) për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për çdo vit akademik. Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet.</p> <p><i>(Evidenca nr. 62 Raport financiar i UAMD, Evidenca nr. 63 Plani Financiar Vjetor i Fakultetit të Studimeve Profesionale, Evidenca nr. 67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; Evidenca Nr.68 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit (kostot e programit MP INF).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe grantin që mer nga MAS të ardhurat nga shërbimet që kryhen.</p> <p><i>Evidenca Nr.68 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit (kostot e programit MP INF).</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-Çdo vit akademik UAMD harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p>- Fondet për financimin e UAMD burojnë nga buxheti i shtetit, të ardhurat e universitetit nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë si dhe tarifat e studentëve. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitet kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në cdo fillim viti akademik.</p> <p>-Çdo vit akademik FSP në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve.</p> <p>-Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat</p>

	e shkollimit dhe grantin që mer nga MAS të ardhurat nga shërbimet që kryhen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu Durrës dhe Fakulteti i SP, kanë hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e UAMD, rregulloret e FSP dhe rregulloret e Departamentit i SHMT dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë MP në Infermieri Kirurgjikale, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS). Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen web të universitetit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD- së, Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD-së, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 10 Rregullore e Programit të Studimit)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>FSP ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme.</p> <p>Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë.</p> <p><i>Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, Evidenca nr. 110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat)</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Para çdo viti akademik pas kërkesës së MAS, departamenti përcakton kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të cilat të cilat miratohen në dekanati dhe aprovohen nga Senati akademik. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike. Senati akademik i dërgon kuotat dhe kriteret e pranimit në MAS. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin e universitetit. Në këto kritere përfshihen dhe parashikohen edhe regjistrimi i studentëve të huaj. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve janë të përcaktuar në rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” dhe Fakultetit të Studimeve Profesionale. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve. (Evidenca nr. 4 Statuti UAMD, Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, në statutin e UAMD dhe në web janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimin e programeve të studimit</li> <li>• Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë</li> <li>• Procedurat e miratimit të kuotave dhe tarifave</li> <li>• Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi</li> <li>• Rregullat e ekuivalentimit etj.</li> </ul> <p>Rregullorja e departamentit, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome. Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen ëeb të Universitetit të Durrësit. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Në statusin e UAMD dhe Rregulloren e departamentit SHMT përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Institucioni ka parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara. (Evidenca nr. 110 Kriteret e pranimit te studenteve dhe kuotat, Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, Evidenca nr. 10 Rregullore e Programit të Studimit)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UAMD dhe FSP kanë në traditën e tyre organizimin e ditëve të hapura informuese në të cilat, prindër dhe gjimnazistë nga gjimnazet e qarkut të Durrësit dhe të qarqeve fqinje ( të cilët janë burimi kryesor i studentëve që frekuentojnë këtë universitet) të cilët janë të interesuar për programet e studimit informohen nga pedagogë dhe studentë. Këto aktivitete</p>

	<p>organizohen zakonisht në periudhën mars – maj dhe kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen web të UAMD.</p> <p><i>(Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 22 Strategjia e komunikimit UAMD)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>UAMD parashikon kuota te posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara, këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara çdo viti akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 21 Rregullore e studentëve me aftësi të kufizuar)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Pas diskutimit me drejtuesit dhe në bazë të dokumentacionit, UAMD dhe Departamenti harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin</p> <p><i>(Evidenca nr. 137 VKM nr. 41 datë 24.01.2018)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UAMD, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselente ne varësi të arritjeve akademikeve. Këto vendime merren nga Bordi i Administrimit të UAMD.</p> <p><i>(Evidenca nr. 1 ligjin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-IAL ka hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</p> <p>-Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" si edhe sipas Udhezimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.</p> <p>-Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</p> <p>- Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin</p> <p>-UAMD cdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë për studentët ekselente ne varësi të arritjeve akademikeve, dhe për studentët nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregulloret është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Frekuentimi i leksioneve, si rregull, është fakultativ. Në përputhje me specifikat e veta, në rregulloren e brendshme të programve të studimit mund të përcaktohen lëndë, frekuentimi i leksioneve të cilave mund të jetë i detyrueshëm deri në masën 80%.</li> <li>2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%.</li> <li>3. Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshëm në masën 100%. Kur studenti nuk ka frekuentuar deri në 25% të laboratorëve të çdo lënde, i shlyen ato në dy javët e fundit të vitit në vazhdim, apo semestrit kur lënda është semestrale. Kur studenti ka frekuentuar me pak se 75% të tyre, i shlyen ato në vitin pasardhës.</li> <li>4. Frekuentimi i praktikave profesionale /mësimore/ spitalore është i detyrueshëm në masën 100%. Në këtë program studimi nuk parashikohet kushtezim midis lëndëve. Në sekretarinë mësimore të FSP mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mësimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet për çdo orë mësimore. Në rregulloret përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin.</li> </ol> <p>1. Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 20 kredite të vitit të parë. 2. Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 20 kredite nga viti i dytë dhe jo më pak se 40 kredite nga viti i parë. 3. Studenti, i cili nuk plotëson kushtet për të kaluar në vitin pasardhës konsiderohet përsëritës i vitit akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr. 8 Rregullorja e FSP, Evidenca nr. 5 Rregullorja e UAMD, Evidenca nr. 9 Rregullorja e DSHTM, Evidenca nr. 10 Rregullorja e programit të studimit, Evidenca nr. 110 Kriteret e Pranimit të Studentëve, të Transferimit e Njohjes së Studimeve të mëparshme)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjeshme. Në të dy rregulloret ka nënë specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. Studentët</p>

	<p>informohen përmes sekretarisë mësimore dhe Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në departament ngrihet një komision i posatshtëm i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacion i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>(Evidenca nr. 8 Rregullorja e FSP, Evidenca nr. 5 Rregullorja e UAMD, Evidenca nr. 9 Rregullorja e DSHTM, Evidenca nr. 10 Rregullorja e programit të studimit, Evidenca nr. 110 Kriteret e Pranimit të Studentëve, të Transferimit e Njohjes së Studimeve të mëparshme)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve/provimeve me shkrim/ me gojë/ projekteve/ prezantimeve/ praktikave.</p> <p>Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.</p> <p>Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë:</p> <p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit, vlerësim i cili përbëhet nga dy komponentë</p> <p>Provimi me shkrim i ndërmjetëm 400 pikë(kolokium)</p> <p>Vlerësimin e vazhduar gjatë semestrit (detyra kursi, projekte, frekuentim, aktivizimi në seminare ) 100 pikë</p> <p>Vlerësimi me provimin përfundimtar 500 pikë.</p> <p>Në syllabuse dhe Rregulloren e FSP neni 50, përcaktohet në mënyrë të detajuar pragu i pikëve kaluese dhe konvertimi i pikëve në nota. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 10 Rregullore programit të studimeve, Evidenca nr. 109 Kërkesë Studenti për Rishikim Provimi dhe Ankimim Rezultati)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Në rregullore përcaktohet:</p> <p>Diplomimi bëhet me mbrojtjen e mikrotezës.</p> <p>Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës.</p> <p>Kushtet që duhet të përmbushë studentit për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit.</p>

	<p>Studenti merr përsipër shpenzimet për realizimin e mikrotezës.</p> <p>GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës).</p> <p>Departamenti përcakton listen e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të vitit akademik. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.</p> <p><i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD, Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 10 Rregullore programit të studimeve master profesional, Evidenca Nr.97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale, Evidenca nr. 111 Memo për Ngritjen e Komisionit të Provimit Final të Diplomimit, Evidenca 112 Njoftim i Sekretarisë për Provimin Final të Diplomimit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj). Informacioni përditësohet dhe në faqen web të UAMD. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rrealizon gjurmimin e studenteve dhe organizimin e ditëve informuese.</p> <p><i>(Evidenca nr. 100 Njoftime në rrjetet sociale të FSP, Evidenca nr. 40 Takime Informues me Maturantët dhe Udhëzuesit e Programit të Studimit)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin dhe gjithashtu është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:</p> <p>-Studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.</p> <p>-Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.</p> <p>-Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>-Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj). Informacioni përditësohet dhe në faqen web të UAMD. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rrealizon gjurmimin e studenteve dhe organizimin e ditëve informuese.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>x</b></p>

<b>Standardi V.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët që ndjekin programet mësimore Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes Sekretarise Mësimore dhe webit ato gjejnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit</li> <li>• Informacion për objektivat formuese të programit</li> <li>• Strukturën dhe organizimin e programit</li> <li>• Planin mësimor</li> <li>• Syllabuset</li> <li>• Rregulloren</li> <li>• Suplementin e diplomës</li> </ul> <i>(Evidenca nr. 4 Statuti UAMD, Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studentit gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studentit orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi (leksion, seminar, praktikë). Studenti i merr të dhënat nga faqja web e Institucionit. <i>(Evidenca Nr.123 Syllabuset Master profesional Infermieri Kirurgjikale)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësorë dhe me Urdhërin e Infermierit dhe institucionet shëndetësore, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Zyra ALUMNI. Institucioni ka mundur të përfshirë studentëve në një sërë aktviteti informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës. <i>(Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 39 Shoqata Alumni UAMD) <a href="https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/">https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/</a></i>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitet jashtë kurrikulare,



shërbimet në funksion të realizimit të tij.	logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitale dhe struktura të shërbimit përcësor. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. <i>(Evidenca nr. 104 Rregullore e sekretarisë mësimore, Evidenca nr. 99 Orari mësimor i tre viteve të fundit, Evidenca nr. 55 Kalendarit i bibliotekës në fundjavë)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në RVB theksohet se UAMD ka një sistem informatik të brendshëm ESSE3, përmes të cilit mundësohet informimi i studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në çdo moment. Veç detajeve për programin e studimit dhe detajeve individuale për notat etj., informacioni i detajur dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen web të Institucionit. <i>(Evidenca Nr.12 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p>-Studentët që ndjekin programin mësimor Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen.</p> <p>- Dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>- Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentojmë që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Në sekretarinë mësimore të FSP janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për programin e studimit. Sekretaria ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrin themeltar të studentëve</li> <li>• Regjistrin e lëshimit të diplomave</li> <li>• Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave)</li> </ul> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p>

	<p>Gjithashtu, Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studenteve dhe disponon të dhëna të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca nr. 70 analiza vjetore e FSP, Evidenca Nr.129 Të dhëna të plota të programit për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit dhe të çregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në sistemin ESSE3 dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore.</p> <p><i>(Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit të Teknologjise së Informacionit, Evidenca nr. 104 Rregullore e sekretarisë mësimore. Evidenca Nr.129 Të dhëna të plota të programit për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat.</p> <p>Të dhënat statistikore të studenteve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse. Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Ato janë të disponueshme si në sekretarinë mesimore ashtu edhe në sistemin ESSE3, këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të UAMD.</p> <p><i>(Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit të Teknologjise së Informacionit, Evidenca nr. 104 Rregullore e sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UAMD ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse që lidhen me organizimin e punës kryejnë kontrolle periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mesimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar.</p> <p>Në kuadër të marrëveshjes për implementimin e sistemit CLEANSCORE procesi i vlerësimit të studentëve është i shpejtë dhe transparent.</p> <p><i>(Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, Evidenca nr. 70 Analiza Vjetore e Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore)</i></p>

	– <i>Shkencore dhe aktiviteve të FSP, Evidenca Nr.62 Raporti financiar UAMD; Evidenca Nr.140 Marrëveshje me Clean Score. trajnimi Clean Score.)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri profesionale. Gjatë takimeve u deklarua që kërkesa të shtuara për punësim ka edhe jashtë Shqipërisë. Zyra së Alumni realizon skedimin i informacionit për punësimin. <i>(Evidenca nr. 70 Analiza Vjetore e Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore – Shkencore dhe aktiviteve të FSP).</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p>-Në sekretarinë mësimore të FSP janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për programin e studimi. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</p> <p>-Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit nga dy struktura përkatëse. Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike.</p> <p>-IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri i profesionisteve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				x

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UAMD. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatit e UAMD me dy senator të cilët zgjidhen nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në Bordin e administrimit, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. <i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD-së, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 46 Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre)</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSP. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik. <i>(Takimi me studentët)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi duke respektuar të gjitha kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Studentët gjykojnë se praktikatat në laboratorët simulatorë dhe praktikatat profesionale në spital i përgatisin mjaft mirë për tregun e punës. Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmesh. Këshilli studentor i cili funksionon në bazë të një rregullore, është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSP për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinator kujdeset për përfshirjen e studenteve në procesin e rishikimit të kurrikulës, GVJ evidenton që rishikimi i programit është kryer në vitin 2020 ku programi nga 90 ETC ka ndryshuar në 60 ETC. Pyetësorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre. Pyetësori zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14-të. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme. Rezultatet e vlerësimit bëhen transparente dhe i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësave të departamentit, si dhe dekanit nga DKSC në Rektorat. Në dokumentacion por dhe në takimin me studentët u evidentua përfshirja e tyre në përmirësimin e raportit teori-praktikë në lëndët profesionale. Nuk ka përputhje të informacionit në tabelën 9 Plani mësimor i programit studimit MP në infermieri kirurgjikale me Plani mësimor në tabelën 10. <i>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr.5 Rregullore e UAMD-së, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut, 106 Pyetësor i vlerësimit të pedagogut, Evidenca nr. 108 Transparenca e Rezultateve të Anketimeve të Studenteve. Evidenca Tabela ASCAL dega MPIK)</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Departamenti pas procesit të ankimimit ngrenjë komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë, i cili ben rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije. <i>(Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD-së, Nenet 68, 69 dhe 70, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UAMD me senator të cilët zgjidhen nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në Bordin e administrimit, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës. Studentët kanë qenë pjesmarrës dhe në hartimin e RVB. -Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. -Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. -Kordinatori i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. -Kordinatori kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;"><b>x</b></p>				

<p><b>Standardi V.6</b> Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>FSP ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve, programin e studimit, aktivitete të lidhura me procesin mësimor. Në funksion të informimit të studentëve janë: Zyra e Karrierës dhe ALUMNI.</p>

	<p>Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim.</p> <p>Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë</p> <p>Zyra e Marrëdhënieve me jashtë</p> <p>Zyra e IT.</p> <p>Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve rubrikën e transparencës dhe Zyra e Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë të studentëve, shpallje njoftime në ambientet e Universitetit, në website ose rrjete sociale.</p> <p>Njëkohësisht Zyra e Karrierës ka si funksion parësor të saj ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe internship-e për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p><i>(Evidenca nr. 39 Shoqata Alumni UAMD, Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 84 Udhëzues nga zyra karrierës – aplikim pune)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët.</p> <p><i>(Evidenca nr. 87 Memo mbi Mentorimet e Studentëve, Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 84 Udhëzues nga zyra karrierës – aplikim pune)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <p>Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë</p> <p>Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune</p> <p>Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës</p> <p>Identifikimin e aftësive dhe shprehive</p> <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p> <p><i>(Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 84 Udhëzues nga zyra karrierës – aplikim pune; <a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a> ALUMNI)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion</p>	<p>Në takimin e GVJ me Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës u informuam se kjo zyrë asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data -bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna gjurmimi e të studentëve pas perfundimit të studimeve u</p>

studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	vihet në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe FSP dhe Departamentit të SHTM. <i>(Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 84 Udhëzues nga zyra karrierës – aplikim pune)</i>		
<b>Konkluzione</b>	-FSP ka procedura dhe njësi të posacme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. -Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre, kjo zyre mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data -bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			x
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

## V. VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një process i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. UAMD në strategjinë e zhvillimit institucional 2020-2025 një vënd të rëndësishëm i kushton zhvillimit të metodave inovative të mësimdhënies me në qëndër studentin duke pomovuar mendimin kritik, dialogun student pedagog dhe përgatitjen e studentëve të aftë për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UAMD ka hartuar një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, zhvillimit të leksioneve të hapura nga lektorë të ftuar jashtë universitetit, vizitat studimore etj. <i>(Evidenca Nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve).</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, në nivel të Fakulteti dhe kordinatorin në nivel programi studimi përgjegjës për cilësinë i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Kështu pranë UAMD - është ngritur dhe funksionon NJSBC në bazë të Rregullore se NJSBC ku përshkruhet si funksionin dhe bashkërendojnë punën njësia qendrore me njësitë në cdo fakultet dhe koordinoret pranë cdo programi. Njësia ka në përbërje sa staf akademik dhe staf administrative. Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore monitoron cilësinë e programeve të studimit. Dertamenti përgatit raportin mbi cilësinë e programeve të studimit dhe ja përcjell NJSBC në Fakultet dhe ky NJSBC në Universitet. Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së programit realizohet nëpërmjet pyetësorëve 2 herë në vit në javën e 13-14 të cdo semestri mësimor, të cilët përgatitet nga NJSBC dhe miratohen nga senati. Cdo vit realizohen tre pyetësorë për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies si: pyetësorë për vlerësimin e lëndës, për vlerësimin e lektorit dhe Infrastrukturën. Gjithashtu analizohet kalendari i realizimit të aktiviteteve të aprovuar në fillim të çdo viti akademik, pyetësorët e vetvlerësimit të stafit akademik. Në bazë të rezultateve të pyetësore përgatitet raporti përfundimtarë për dekanin. Rezultatet e pyetësorëve i kanë shërbyer zgjidhjes së problematikave lidhur me këto tre shtylla vlerësimi. Këto u theksuan dhe gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët.</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca nr. 78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit studenteve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, dy herë në vit plotësojnë pyetësorët për vlerësimin e metodave të mësimdhënies. Në fund të cdo viti akademik Institucioni përpilon raportin bazuar në të dhënat e tërhequra nga këta pyetësorë. Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin si të institucionit në përgjithësi ashtu është të programeve apo lëndëve specifike.</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënies bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Siç u theksua dhe më lart pranë UAMD funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studenteve për matjen e performancës. Në fund të çdo semestri 13 -14 apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.</p>



	<p>Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Me tej strukturat përgjegjëse hartojnë (institucioni) një raport në përmblyllje të cdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p>Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë".</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca nr. 106 raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull).</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ vlerëson së të dhënat në raportin përfundimtar janë përshkruese në terma sasiorë dhe analitike si dhe me adresim të problematikave të hasura dhe rekomandimet për masa konkrete. Këto të dhëna shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies si përcaktim e kriterëve dhe afateve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj.</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, në nivel të Fakulteti dhe kordinatorin në nivel programi studimi i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit.</p> <p>- UAMD ka hartuar një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>-Studenteve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti.</p> <p>-Të dhënat në raportin përfundimtar të NJSBC janë përshkruese në terma sasiorë dhe analitike si dhe me adresim të problematikave të hasura dhe rekomandimet për masa konkrete.</p> <p>-Të dhënat e raportit të NJSBC shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies si përcaktim e kriterëve dhe afateve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin eteknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>x</p>

<p><b>Standardi VI.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në rang Universiteti, Fakulteti dhe njësie bazë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UAMD, në rregulloren e institucionit si dhe në planin strategjik të institucionit 2020-2025. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. Në dokumenacionin e venë ne dispozicion gjejmë evidenca të vendimeve të senatit për aprovimin e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve administrative, vendimeve për aprovimin e formateve të vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>(Evidenca nr.11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca Nr.06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025. Evidenca Nr.07 Planifikimi veprimtarive strategjike 2021-2023)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UAMD ka ngritur Drejtorinë e Kurrikulave e cila përbëhet nga dy sektorë sektori i sektori mesimor dhe sektori I sigurimit te cilesise. Sektorët mbulojnë të gjithë problematikat nga licensimi ne akreditim. NJSBC , dhe e bazon aktivitetin e saj në:</p> <p>Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015 Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018) Statuti i institucionit Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktiviteteve si : Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njësive në nivel institucional. Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në njësitë bazë. Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca nr.11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,</p>	<p>UAMD i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional dy herë, duke marrë një akreditim prej 5 vite në vitin 2016 dhe 4 vite në akreditimin e dytë në vitin 2022. GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC evidenton që institucioni përdor</p>

<p>vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>mekanizma të tillë si pyetësorët e vlerësimit të studentëve, vlerësimit të anëtareve të stafit akademik, vetëvlerësimit të pedagogëve, vlerësimin e infrastrukturës.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaroi se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të UAMD dhe hartoi Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Metodatat të cilat aplikohen janë: pyetësorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura, intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës etj.</p> <p>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike UAMD ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesive të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik. Treguesit e performancës përfshijnë tregues të tillë si: niveli i regjistrimeve, niveli kalueshmërisë, niveli i diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj</p> <p>NJSBC përipiqet për monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë standartizuar si procese që kryhen si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë .</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca nr. 106 raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull, Evidenca Nr.107 Anketimi i studentëve, evidenca Nr.108 Transparenca e Rezultateve të Anketimeve të Studentëve).</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, nivel fakulteti dhe njësie bazë.</p> <p>-NJSBC kryhen monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë të standartizuara si procese permanente që kryhen në mënyrë periodike si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë</p> <p>- Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike UAMD ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesive të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">x</p>

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>FSP përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.</p> <p>Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <p>Analiza vjetore e departamentit; Vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik; Pyetsori i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien, infrastrukturën dhe vlerësimi i stafit akademik.</p> <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të parë të studimeve, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të FSP në përputhje me standardet si dhe të monitoroj punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL.</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve gjatë diskutimeve me drejtuesit u theksua se një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSP ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL. NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të UAMD-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, mendimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj. Procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe në funksion të cilësisë.</p> <p>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin vjetor të NJSBC.</p> <p>Megjithatë, GVJ evidenton se raportimet vjetore janë informative, analitike, dhe luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin të cilësisë apo treguesëve të veçantë të saj. Njësia qendrore dhe njësia bazë bazuar në raportin vjetorë angazhohen për zgjidhjen e problematikave të evidentuara nga grupi i vlerësimit dhe ndërmarrin masa për përmirësimin e programit të studimit sipas rekomandimeve përkatëse.</p>




	<p>Njësia luan rol kryesor jo vetëm në hartimin e planit të punës apo zhvillimin e pyetësorëve standartë si dhe në përfshirjen e metodave të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve të përafrohen realitetit në të cilin ndodhet institucioni.</p> <p>NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e vet duke u bazuar në rekomandime dhe plane pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara.</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca Nr.126 Raportet e kordinatorit të programit të studimit mbi ecurinë e programit të studimit, metodat e mesimdhënies, takimet me strukturat studentore., Evidenca Nr.24 Raporti i sigurimit të cilësisë UAMD).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Njësia kryesore, në fund të cdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSP. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Të dhënat i dërgohen Senatit të UAMD duke krijuar mundësi me të shpejtë adresimi dhe zgjidhje të problematikave.</p> <p><i>(Evidenca Nr.70. Analiza vjetore e FSP 2020- 2021;Evidenca Nr.67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; plani për mbështetje financiare, Evidenca Nr.68 Te dhëna nga plani i financimit të programit të studimit (kostot e programit Mami).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mesimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamentet e FSP analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë:</p> <p>Numri i studentëve frekuentues</p> <p>Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikve</p> <p>Plotësimi i standarteve të grupeve mësimore</p> <p>Plotësimi i standarteve të stafit akademik</p> <p>Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve</p> <p>Kalueshmëria dhe cilësia semestrale</p> <p>Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale</p> <p>Numri i të diplomuarve</p> <p>Kalueshmëria në provimin e shtetit</p> <p>Konkluzionet e pyetsorit të studentëve</p> <p><b>(Takimi me stafin drejtues të FSP, NJSBC)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të</p>	<p>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim ze informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni për punësimin e</p>

<p>diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>studentëve. Përmes kësaj zyre mbahen kontakte me studentëve që kanë përfunduar më parë këte program studimi meret informacion për punësimin e tyre apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Metoda të tjera janë sondazhe me studentët aktual që ndjekin programin e studimit MP në Infermieri Kirurgjikale, por dhe studentët e diplomuar dhe të punësuar, nëpërmjet kontakteve që gjenden në databazën e zyrës së Alumni. Këto sondazhe shërbejnë për të vlerësuar si mirëpritën studentët në tregun e punës dhe si vlerësohet aftësia që ata kanë fituar nga programi i studimit dhe integrimi i tyre në tregun aktual. Institucioni informohet në mënyrë periodike për rezultatet e studentëve në provimin e licencës.</p> <p>Pasi përpunohen të dhënat, rezultatet bëhen publike nëpërmjet një raportit të shkruar apo dhe takimeve të hapura me stafin akademik të njësisë kryesore më qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe mundësitë për ndryshime në programin e studimit në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale. Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit Mami.)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>-FSP përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit.</p> <p>- Njësia kryesore, në fund të cdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>-Të dhënat e vlerësimit të programeve të studimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSP. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Të dhënat i dërgohen Senatit të UAMD duke krijuar mundësi me të shpejtë adresimi dhe zgjidhje të problematikave. ë përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSP.</p> <p>- Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi si nr e studentëve të licensuar, të punësuar etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>x</b></p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2020-2025 të UAMD përfshin politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me Konventën Europiane, planin e ndërkombëtarizimit të UAMD, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare në mënyrë që programi i studimit të njihet sa më lehtë në vëndet e huaja dhe/ose realizimin e diplomave të dyfishta. në funksion të saj prioritare mbetet zhvillimi I programeve mësimore në gjuhën angleze, rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve të huaj. Gjithashtu, në vëmendjen e Institucionit do të jetë edhe ndërkombëtarizimi i doktoraturave, nëpërmjet forcimit të dimensionit ndërkombëtar, të bashkëpunimit efektiv në nivel shkencor me Universitetet e huaja, përfshirjes në projekte ndërkombëtare pasi kërkimi shkencor po bëhet gjithmonë e më shumë i hapur dhe i ndarë me të gjithë.</p> <p>Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor do realizohen nëpërmjet zhvillim të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve. Kjo kushtëzon: leksione që dalin edhe nga kërkimi i drejtpërdrejtë; përfshirjen e studentit në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogun e të drejtuara prej tij; shndërrimin shkallë-shkallë të raportit “pedagog-student” në “udhëheqës-kërkues”, sidomos në nivelin master e doktoraturë.</p> <p>Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në hartimin e politikave të zhvillimit strategjik dhe në politikat e ndërmarra për ndërkombëtarizimin e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidenca Nr.19 Strategji ndërkombëtarizimi UAMD 2019-2021)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSP, Përgjegjësit e Departamenteve të SHMT, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit, është konceptuar si Përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Harmonizimin e veprimtarisë të të gjitha strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit MP në “Infermieri Kirurgjikale”;</li> </ul>

	<p>- Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit;</p> <p>- Hartimin e një programi cilësor që plotëson nevojat e shoqërisë;</p> <p>- Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë,</p> <p>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetësorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.</p> <p><i>(Evidenca Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale.pdf Evidenca Nr.09 Rregullore e Departamentit të Shkencave Teknike Mjeksore Evidenca, Nr.10 Rregullore e programit të studimit MP infermieri kirurgjikale).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni UAMD, Fakulteti dhe njësie bazë e cila koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, siç është Personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve.</p> <p><i>Evidenca Nr.11 Rregullore Sistemi brend sigurimi cilësise (NJBSC)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Procedura e vlerësimit të brendshëm I nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UAMD. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangët çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve.</p> <p><i>Evidenca Nr.29 Kodi i etikës i UAMD</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><b>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit është përfshirë dhe një ekspert i jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon.</b></p> <p>Në procesin e vlerësimit institucioni realizon takime me ish të diplomuar, mjekë specialiste, eksperte të DSHP të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës.</p>






<b>Konkluzione</b>	<p>-Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2020-2025 të UAMD përfshin politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me Konventën Europiane, planin e ndërkombëtarizimit të UAMD.</p> <p>-NJSBC funksionon në nivel institucioni UAMD, Fakulteti dhe njësie baze e cila koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.</p> <p>- Ne vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, sic është Personelit akademik, ndihmes akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve.</p> <p>- Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor do realizohen nëpërmjet zhvillim të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve.</p> <p>- Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit institucioni ka përfshirë dhe një ekspert të jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit etj. gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri , të cilët publikohen rregullisht dukë rritur transparencën. Në hartimin e raportit NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 9887/10.03.2008 ndryshuar me ligjin 48/2012). Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve.

	<p>Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet web për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p><i>(Intervista me stafin akademik dhe studimit)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. <b>GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</b></p> <p>Nga shyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se FSP dhe depratamenti i Shkencave Mjekësore teknike kanë zhvilluar një sërë aktivitete me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre për zgjidhje të situatave të dryshme në praktikën klinike, aktivitete kërkimore shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Vlen të theksohet dhe mbështetja e institucionit për stafin akademik për rritjen e tyre profesionale si pjesmarrjen në aktivitete shkencore apo pagimi i fee për botime në revista me faktor impakti apo Scope.</p> <p><i>(Takimi me stafin akademik, RVB)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>				
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit.</p> <p>-NJSBC realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri , të cilët publikohen rregullisht dukë rritur transparencën. Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve dhe merren masa korrigjuese përkatëse.</p> <p>- Raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>x</b></p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Mastër Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.**

**Pika të forta**

1. Kurrikula e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hartuar bazuar në modelet kombëtare dhe Europiane për profesionet e rregulluara, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
2. Staf akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë në mësimdhënie për implementimin e programit të studimit.
3. Infrastruktura fizike e UMAD, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit si dhe infrastruktura në dispozicion të programit të studimit për realizimin e praktikës mësimore, e cila përbëhet nga Laboratori i infermieristikës i pajisur me pajisiet e nevojshme mjekësore (mulazhe, manikina, aparat respiracioni, Ekage etj) ku kryhen procedurat infermirore i shërbejnë aftësimin profesional të studentëve.
4. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencës së studentëve dhe pedagogëve me Institucione të Arsimit të Lartë në vende Europiane të cilat ofrojnë programe te ngjashme studimi (programin Ceepus si Universiteti Nikolla Koprtniku Poloni, Universiteti shkencave Mjekësore Kaunas Lituani, universitetin Ankaras Turqi etj.) të finacuar nga Erasmus+, si dhe një sërë projektsh ndërkombëtare në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor.
5. Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka UMAD me institucione shëndetësore publike dhe jo publike për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, realizimi i temave të diplomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimi i kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë.
6. Mbështetja financiare nga institucioni e stafit akademik për kërkimin shkencor nëpërmjet parashikimit çdo vit të një buxheti të veçantë, si dhe administrimi i të ardhurave të siguruara nga aktivitete të ndryshme nga departamenti.
7. Sigurimi i fondeve financiare për kërkimin shkencor jo vetem nga burime te brendshme të institucionit, por edhe nga burime te jashtme përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare të njësisë bazë/departamenti.
8. Përfshirja në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit të një eksperti të jashtëm nga institucionet bashkëpunuese.

### **Pika të dobëta**

1. Numri i lartë i stafit akademik me kontartë në implementimin e programit mesimor (raporti PAE/PAK varion nga 15/53 në 16/49) e cila nuk përputhet me aktet ligjore në fuqi.
2. Mungesa e teksteve mësimore në shumicën e lëndëve të këtij programi studimi. Pjesa më e madhe e lëndëve bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët, tekstet në disa lëndë janë të vjetëruara. Literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar.

### **Rekomandime**

1. Rekrutimi i stafit akademik efektiv për realizimin mbi 70% të ngarkesës së programit mësimor bazuar në aktet ligjore në fuqi.
2. Hartimin e teksteve mësimore bazë në gjuhën shqipe dhe përditësimin e literaturës bazë. Shtimin e literaturës mjekësore bazë të viteve të fundit në bibliotekë.
3. Pasurimin e literaturës mjekësore me botime të fundit dhe me tituj të rinj në fushën e shkencave mjekësore.
4. Bashkëpunimin më të mirë mes pedagogëve dhe stafit administrativ dhe drejtues të FSP për realizimin e procedurave të blerjes së literaturës mjekësore.

### **Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Surgical Nursing" provided by the Higher Education Institution "Aleksandër Moisiu", Durrës.**

#### **Strength points**

1. The curriculum of the Professional Master's study program in "Surgical Nursing" is designed based on national and European models for regulated professions, respecting the standards and legal framework in force.
2. Qualified Academic staff with experience in teaching for the implementation of the study program.
3. The physical infrastructure of UMAD, learning environments, information technology, as well as the available infrastructure to this study program for the realization of teaching practice, which consists of the nursing laboratory equipped with all necessary equipment (such as models, mannequins, medical equipment, etc.) where the student performed nursing procedures for their professional training.

4. Cooperation and exchange of experience of students and lecturers with Higher Education Institutions in European countries that offer similar study programs (Poland, Lithuania, Ankara University Turkey etc.) funded from Erasmus+ program, as well as a number of international projects in the function of education and scientific research.
5. Cooperation agreements of UMAD has with public and non-public health institutions for the realization of the professional practice of students, the realization of diploma topics or scientific research, as well as the creation of contacts for continued employment since some of the collaborators are direct employers.
6. Financial support from the institution of the academic staff for scientific research through the provision of a special budget each year as well as the administration of the income provided by different activities from the department.
7. Providing financial funds for scientific research not only from internal sources of the institution but also from external sources through participation in international projects of the base unit/department.
8. Involvement in the internal evaluation process of the study program of an external expert from the cooperating institutions.

#### **Weaknesses:**

1. The high number of academic staff with contracts in the implementation of the educational program (the ratio ASE/ASC varies from 15/53 to 16/49) which does not comply with the legal acts in force.
2. The lack of text books in most of the subjects of this study program. Most of the subjects in this study program are based on written lectures by themselves lecturers, the textbooks in some subjects are outdated. The mandatory and recommended literature in the syllabus is outdated.

#### **RECOMMENDATIONS**

1. Recruitment of effective academic staff for the realization of over 70% of the teaching program load based on the legal acts in force.
2. Drafting basic teaching texts in the Albanian language and updating the basic literature. The addition of basic medical literature of recent years to the library.
3. Enrichment of medical literature with recent publications and new titles in the field of medical sciences.
4. The best cooperation between lecturers and the administrative and management staff of FSP for the realization of purchase procedures of medical literature.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X